Platforma Regjionale e Ballkanit Perëndimor për Avokim të Lirisë së Medieve dhe Sigurisë së Gazetarëve
Western Balkan's Regional Platform for Advocating Media Freedom and Journalists' Safety

This project is funded by The European Union

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [KOSOVA]

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve [KOSOVA]

Autor: Petrit Çollaku

Dhjetor 2016

Titulli origjinal
Treguesit e nivelit të lirisë së mediave
dhe sigurisë së gazetarëve (Kosova)

Botuesi
Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës

Autor
Petrit Çollaku

Redaktor
Natyra Avdiu

Lektor
Florian Agalli

Dizajni
comma | communications design

Ky publikim është prodhuar me ndihmën financiare të Bashkimit Europian.
Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Asociacionit të Gazetarëve
të Kosovës dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet që reflekton pozicionin e
Bashkimit Europian.

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive **5**

Treguesit A:
Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve 6

Treguesit B:
Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës 7

Treguesit C:
Siguria e gazetarëve 7

Rekomandime 9

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve **11**

Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve 12

Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës 13

Siguria gazetarëve 13

A .Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve **15**

A.1 A siguron legjislacioni kombëtar garanci për lirinë e mediave dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë? 15

A.2 A shkakton ligji i shpifjes një efekt "trishtues" mes gazetarëve? 19

A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatave zgjedhore? 21

A.4 A është liria e punës dhe asosiacionit e garantuar dhe e zbatuar në praktikë? 23

A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve? 26

A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata? 27

B. Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës **31**

B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike ë gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre? 31

B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e mediave dhe strukturat udhëheqëse? 33

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK? 35

B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës? 36

B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve? 36

C. Siguria gazetarëve **39**

C.1 Siguria dhe statistikat e pandëshkueshmërisë 39

C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve? 42

C.3 A i trajton me efektivitet sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve? 42

Lista e personave të intervistuar 45

Shtojca **45**

Bibliografi 47

Referenca dhe burime **47**

Dokumentet ligjore, politika 49

Artikujt të mediave 49

Përmbledhja ekzekutive

Ky raport paraqet rezultatet e hulumtimit të kryer në kuadër të projektit rajonal *Platforma Rajonale e Ballkanit Perëndimor për avokim për lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve*[1], i cili zbatohet nga shoqatat kombëtare të gazetarëve në Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni, Mal të Zi dhe Serbi. Objektivi kryesor i hulumtimit ishte sigurimi i vlerësimit bazë dhe dëshmive mbi nivelin e lirive të mediave dhe sigurisë së gazetarëve, që do të përdoren më tej në një mekanizëm rajonal për monitorim dhe avokim për liritë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve në nivel lokal, kombëtar dhe rajonal.

Studimi u realizua nga një ekip hulumtues rajonal, i përbërë nga një drejtues[2] dhe pesë hulumtues në nivel vendi, të emëruar nga shoqatat kombëtare të gazetarëve. Hulumtimi në Kosovë u realizua nga Petrit Çollaku, në bazë të një metodologjie të përbashkët për të pesta vendet. U përdor një gamë e metodave të ndryshme kualitative dhe kuantitative për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave:

1 *Projekti është financuar nga Komisioni Evropian, në kuadër të Programi i Mediave dhe Shoqërisë Civile 2014-2015, Mbështetje për rrjetet rajonale tematike të Organizatave të Shoqërisë Civile.*
2 *Ekipi hulumtues u kryesua nga Dr. Snezana Trpevska, eksperte e ligjit për media dhe metodologjisë së hulumtimit.*

- *Analiza cilësore e dokumenteve* (ACD) e studimeve hulumtuese dhe analizave të prodhuara nga organizata të tjera hulumtuese, akademikë, OJQ, hulumtues individualë etj.; e dokumenteve zyrtare të prodhuara nga institucionet publike (aktet ligjore, nënligjore, strategjitë, raportet vjetore, procesverbalet nga mbledhjet, njoftimet për shtyp) dhe mbulimit mediatik (tekste, artikuj, raportet e lajmeve dhe materiale të tjera të publikuara).
- *Intervistat cilësore* me 14 individë (gazetarë, juristë, ekspertë të mediave, përfaqësues të institucioneve publike ose OJQ).
- *Anketa* me 50[3] gazetarë nga organizata të ndryshme mediatike mbi bazën e një pyetësori të strukturuar, të zhvilluar në kuadër të hulumtimit "Bota e Gazetarisë"[4].
- *Të dhëna zyrtare statistikore* të kërkuara nga institucionet publike ose të mbledhura nga faqet e internetit në dispozicion ose nga burime të tjera të botuara.

Pavarësisht përmirësimeve marginale, situata e përgjithshme në lidhje me lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve vazhdon të jetë e ndjeshme në Kosovë. Gazetarët vazhdojnë të kërcënohen dhe të sulmohen fizikisht, ndërsa qasja e sistemit të drejtësisë për trajtimin e rasteve të gazetarëve në mënyrë efektive është ende sfiduese.

Treguesit A: Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve

Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e mediave. Veç saj, ka disa akte të tjera legjislative që rregullojnë punën e gazetarëve dhe të mediave. Korniza ligjore e mediave konsiderohet se përmbledh garancitë dhe normat kryesore që mbrojnë lirinë e shprehjes, edhe pse zbatimi në praktikë mbetet i dobët (Seksioni A.1).

Teksa kuadri ligjor ofron garanci për lirinë e shprehjes, mediave dhe informacionit, vlerësimi i përgjithshëm i të gjithë gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar është se zbatimi i garancive të tilla ligjore është i dobët. Një nga arsyet e cituara për këtë, është reagimi i ngadaltë i sistemit të drejtësisë edhe në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Gjithashtu, disa institucione shtetërore nuk e kanë parë të arsyeshme që në takimet publike të hartimit të rregulloreve të reja që merren me komunikimin publik ta ftojnë edhe AGK-në. Këto raste janë veçanërisht të rëndësishme për shkak të lëndës së rregullave të propozuara, por mungesa e transparencës së institucioneve shtetërore të Kosovës ka rezultuar në përjashtimin e kontributeve të vlefshme për një proces të rëndësishëm, jovetëm për gazetarët, por për interesin publik në tërësi. AGK u rekomandon institucioneve publike të sigurojnë hapësirë për bashkëpunim me komunitetin e gazetarëve, kur të jetë në pyetje legjislacioni i mediave në të ardhmen. (Seksioni A.1, faqe 12).

Institucionet publike në Kosovë u sigurojnë mediave sasinë më të madhe të të ardhurave nga reklamat. Sigurimi i kontratave me institucionet publike ndikon në politikën editoriale të mediave. Megjithatë, Ministria e Financave nuk ishte në gjendje të tregonte me statistika ku kanë shpenzuar më shumë institucionet. Megjithatë, disa ministri raportuan në lidhje me shpenzimet e tyre për shpallje në shtyp dhe media online. (Seksioni A.1, faqe 14).

Së fundmi, Radio Televizioni i Kosovës (RTK), transmetuesi publik, është përballur me një numër sfidash. Njëra prej tyre ka të bëjë me mosmarrëveshjet mbi financimin, e tjetra lidhet me përdorimin e ndërtesave të caktuara. Për më tepër, është e rëndësishme që RTK, për shkak të raportimit jo konfrontues, sidomos për ata që janë në qeveri, është kritikuar publikisht për mungesën e pavarësisë editoriale dhe ndërhyrjen e politikës. Në të njëjtën kohë, RTK ka qenë edhe shënjestra e sulmeve me granata dore gushtin e kaluar, një në ndërtesën e televizionit dhe një tjetër në shtëpinë e Drejtorit Gjeneral. (Seksioni A.1, faqe 14).

Vitet e fundit, legjislacioni i Kosovës ka pasur disa zhvillime. Në veçanti, u mor një vendim i rëndësishëm për t'iu bashkuar pjesës tjetër të vendeve të rajonit në dekriminalizimin e shpifjes. Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes i vitit 2012 nuk konsiderohet se siguron mbrojtje të zgjeruar për të mirën e zyrtarëve shtetërorë. Ligji nuk është testuar si duhet nga ana e gjykatave, ndërkohë që shumë padi janë në pritje të trajtimit. (Seksioni A.2)

Sektori i mediave ka një qasje lehtësuese ndaj partive politike dhe sigurimit të hapësirës për to në programet e tyre të lajmeve. Shumë prej mediave vendore kanë mbuluar aktivitetet dhe qëndrimet e përfaqësuesve të ndryshme politikë në programet e tyre, veçanërisht në edicionet e tyre të lajmeve gjatë periudhës së zgjedhjeve. Në përgjithësi, raportet mbi monitorimin e mediave gjatë kohës së zgjedhjeve tregojnë se mediat kanë mb-

3 *Qëllimisht, anketa u krye mbi një kuotë kampion prej 50 gazetarësh nga llojet e ndryshme të mediave në Kosovë: 10 gazetarë nga transmetuesi publik, 16 nga stacione private radio dhe TV, 5 nga media private të shkruara, 5 nga agjenci lajmesh, 14 nga media online. Është e rëndësishme të theksohet që edhe pse kuota kampion nuk lejon nxjerrjen e përgjithësimeve në nivel të të gjithë popullsisë së gazetarëve, përgjigjet e marra nga anketa ofrojnë njohuri të vlefshme mbi gjendjen e tashme me liritë e mediave dhe gazetarëve në Kosovë.*

4 *Mund të gjendet në: http://www.worldsofjournalism.org/*

uluar fushatat e partive politike dhe kandidatëve në pajtim me ligjin. (Seksioni A.3)

Gazetarëve në Kosovë nuk u kërkohet të licencohen nga autoritetet shtetërore për të filluar karrierën e tyre në gazetari. Gjithashtu, nuk ka përpjekje nga autoritetet shtetërore për të imponuar licencimin ose kërkesa të tjera për media të shtypura dhe në Internet. (Seksioni A.4)

Në disa raste, AGK është njoftuar për moslejimin e pjesëmarrjes së gazetarëve në ngjarjet e organizuara nga zyrtarët e qeverisë, për shkak të raportimit të mëparshëm kritik. Gjithashtu, nuk ka kërkesa ndaj gazetarëve në Kosovë që të pajisen me licencë për të punuar si gazetarë. (faqe 22)

Gjithashtu, një tjetër zhvillim i rëndësishëm në legjislacionin vendor është miratimi i ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Ligji u mirëprit nga komuniteti i gazetarëve që kërkojnë ta mbrojnë punën e tyre. Janë raportuar raste sporadike kur gazetarët janë kërcënuar nga institucionet shtetërore për të zbuluar burimin e informacionit. (Seksioni A.5, faqe 25).

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen gazetarët është zbatimi i dobët i ligjit për qasje në dokumente publike (Seksioni A.6). Edhe pse qeveria mburret se lejon qasje në dokumente publike, gazetarët e intervistuar dhe të anketuar pohojnë se institucionet shtetërore nuk i zbulojnë dokumentet publike të nevojshme për raportimin e tyre.

Treguesit B: Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

Një shqetësim tjetër që është identifikuar në hulumtim përfshin mungesën e kontratave për gazetarët, të cilët e konsiderojnë atë si trysni të drejtpërdrejtë të ushtruar mbi ta nga pronarët e mediave. Kjo trysni ndikon në pavarësinë dhe paanshmërinë e gazetarëve. (Seksioni B.1)

Përvoja e punës dhe punësimi, deri në një masë, mund ta plotësojnë hendekun në sigurimin e një pasqyre të aspekteve praktike të profesionit. Megjithatë, nuk ka shumë investime për zhvillimin e gazetarëve apo aftësive të tyre të caktuara. Në anketën me gazetarë u tha se pagat e tyre shkojnë nga 200 deri në 500 euro (Seksioni B.1).

Gazetarët gjithashtu ankohen për vonesat e pagave dhe në disa raste vonesa zgjat me muaj. Mungesa e sigurisë financiare është një shqetësim i veçantë, për shkak se gazetarët mund të bëhen të varur nga pronarët, të cilët i keqpërdorin në lidhje me raportimin, qoftë duke zgjedhur perspektivat e raportimit të një lajmi ose duke vendosur të raportohet apo jo.

Mungesa e pronësisë së mediave vazhdon të mbetet problematike, veçanërisht në lidhje me disa media online. Kjo trysni i ka vendosur gazetarët në një pozitë të palakmueshme dhe të paqëndrueshme, e disa prej tyre theksojnë se kur veprojnë në një mjedis të tillë, gazetarët ndërtojnë një vetëdije, madje edhe autocensurë në lidhje me llojin e lajmeve që duhet të sjellin në redaksi që t'u përshtaten pikëpamjeve dhe qëllimit të pronarit (Seksioni B.2).

Transmetuesi publik e ka kodin e vet të sjelljes që konsiderohet shumë i avancuar. Megjithatë, shumica e gazetarëve të intervistuar pohojnë se kodi zbatohet dobët në praktikë nga gazetarët e RTK-së, dhe kjo është për shkak të ndërhyrjes aktive politike, direkt në politikën editoriale. (Seksioni B.3)

Mediat jo-fitimprurëse janë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës për media të shkruar dhe vizive, ndërsa disa kanë kode të brendshme të sjelljes. Sektori jo-fitimprurës i mediave qëndron më mirë në lidhje me financat, duke pasur parasysh se funksionon bazuar vetëm në donacione. Sektori jo-fitimprurës është përlyer me akuzat për financime dhe burime të dyshimta. (Seksioni B.4)

Gazetarët thonë se ndihen që gëzojnë liri më të madhe për të sugjeruar tema, dhe më pak liri për të vendosur se cilat aspekte të një lajmi duhen theksuar, apo perspektivën që lajmi duhet të përfshijë. (Seksioni B.5)

Treguesit C: Siguria e gazetarëve

Siguria e gazetarëve mbetet një shqetësim, dhe këtu kontribuon mungesa e efikasitetit të sistemit të drejtësisë. Hulumtimi gjeti se nuk ka mekanizma filtrimi në sistemin e drejtësisë për t'u marrë në mënyrë efektive me rastet e gazetarëve të kërcënuar apo të sulmuar, sidomos të femrave gazetare. (Seksioni C.1)

Në lidhje me ndonjë incident të raportuar kundër gazetarëve dhe nga gazetarët, Policia e Kosovës përfundon hetimin dhe rastet ia kalon prokurorisë. Kjo e fundit nuk ishte në gjendje të raportonte sa raste janë ende nën hetime dhe sa aktakuza janë ngritur në tre vitet e fundit. (Seksioni C.1)

Gazetarët kanë gjasa të jenë viktima të prekshme për shkak të një sërë arsyesh, duke përfshirë subjektin e

kërcënimeve, pasi ky mund të jetë punëdhënësi i tyre apo një individ ose zyrtar publik për të cilin ata duan të raportojnë. (Seksioni C.1)

Një nga rastet historike që kanë mbetur të pazgjidhura dhe sfidë e madhe për sistemin e drejtësisë, është dështimi i saj për të hetuar siç duhet, identifikuar dhe ndjekur penalisht autorët vrasjeve të tre gazetarëve pas luftës. Një element veçanërisht shqetësues i këtij rasti është se vrasjet e gazetarëve janë konsideruar të motivuara politikisht. (Seksioni C.1)

Hetimi fillon me policinë, prokurorinë dhe shtrihet deri në gjykata, të cilët duhet të fokusojnë përpjekjet e tyre për të identifikuar ato viktima të pambrojtura, të sigurohen se raportimet e çdo krimi hetohen si duhet dhe çështjet trajtohen me shpejtësi dhe pa vonesa të panevojshme. Siç dihet mirë, drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, edhe pse me interes të mëtejshëm është se fusha në të cilën punojnë gazetarët mund të rezultojë në një situatë që bëhet e paqëndrueshme shumë shpejt, dhe një qasje e pakoordinuar dhe e vonuar mund të rezultojë me pasoja të dëmshme për gazetarët, duke përfshirë edhe humbjen e jetës. (Seksioni C.2)

Ka disa raste që gjykatat vendore kanë dhënë vendime për dënime të pezulluara për autorët e kërcënimeve. Në rastin e tentativës së vrasjes së një gazetari në vendin e tij të punës, gjykatës iu desh një vit për të marrë vendim, i cili rezultoi në ndëshkimin e autorit me katër vjet burg. (Seksioni C.3)

Për më tepër, është raportuar se sundimi i ligjit në Kosovë nuk ndjek të gjithë zinxhirin e aktorëve në sulme, çka jo vetëm nuk sjell drejtësi për viktimat e krimit, por edhe ka një ndikim negativ në perceptimin dhe efektivitetin potencial të zbatimit të ligjit. (Seksioni C.3)

Siguria e gazetarëve mbetet shqetësuese, sidomos për shkak të sjelljes së paparashikueshme të punëdhënësve dhe figurave publike ndaj gazetarëve, qofshin zyrtarë shtetërorë ose pronarë biznesesh, andaj sistemi efektiv i drejtësisë është i domosdoshëm. Teksa situata aktuale është larg nga e dëshirueshme, është e rëndësishme që sistemi i drejtësisë i Kosovës të marra hapat e nevojshëm për të përmirësuar efektivitetin kur trajtohen kërcënimet dhe sulmet ndaj mediave dhe gazetarëve, dhe të sigurohet që i gjithë zinxhiri i aktorëve në sulme të hetohet tërësisht. (Seksioni C.3)

Rekomandime

Institucionet publike duhet të marrin në konsideratë në mënyrë aktive mënyra për të përmirësuar zbatimin e ligjit për qasje në dokumente publike, dhe përgjigjet duhet të sigurohen menjëherë.

Institucionet shtetërore të merren efektivisht me rastet e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve, përfshirë edhe marrjen parasysh të krijimit të mekanizmave filtruese dhe bashkëpunimin e ngushtë me organizatat e gazetarëve.

Pronarët e mediave t'u sigurojnë kontrata pune punonjësve dhe të respektojnë ligjin e punës. Inspektorati i Punës të sigurohet për zbatimin e ligjit të punës, në mënyrë që gazetarët të mos kthehen në viktima të shfrytëzimit.

Inspektorati i Punës të kryejë inspektime të rregullta në media dhe të nxjerrë raporte vjetore mbi gjendjen e mediave në lidhje me të drejtat e punës të punonjësve të mediave.

Policia të trajtojë me përparësi të gjitha rastet kundër gazetarëve, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet, frikësimet dhe shantazhet.

Policia të sigurohet që zyrtarët e saj do të marrin pjesë në trajnime dhe debate mbi marrëdhëniet mes forcave të sigurisë dhe mediave.

Policia të sigurohet se do t'i hetojë plotësisht rastet që përfshijnë rrezikimin e gazetarëve. Policia të sigurohet se do të hetojë të gjithë zinxhirin e sulmit.

Prokuroria t'i trajtojë me përparësi rastet e gazetarëve dhe të ofrojë procese të përshpejtuara për rastet në gjykim.

Prokuroria të sigurohet që zyrtarët e saj do të marrin pjesë në trajnime dhe debate mbi marrëdhëniet mes prokurorisë dhe mediave.

Të forcohet Avokati i Popullit duke ofruar mundësi për rritjen e kapaciteteve dhe të vazhdohet bashkëpunimi me mediat

Gjykatat të trajtojnë me përparësi të gjitha rastet kundër gazetarëve, duke përfshirë sulmet fizike, kërcënimet, frikësimet dhe shantazhet.

Gjykatat të kenë procese, të tilla si një bazë të dhënash, ku të regjistrohen dhe arkivohen të gjitha rastet e gazetarëve.

Partitë politike të kufizojnë trysninë në punën e transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës

Kuvendi i Kosovës të përqendrohet në Radio Televizionin e Kosovës për të gjetur një mënyrë për financimin afatgjatë dhe për të zgjidhur çështjet e pronës

Kuvendi i Kosovës të sigurojë mbikëqyrje më të madhe të punës së transmetuesit publik, Radio Televizionit të Kosovës, dhe të miratojë një rol më të madh në promovimin dhe shqyrtimin e zbatimit të lirisë së shprehjes, mediave dhe informacionit

Organet vetërregulluese (KPM dhe KMSHK) të vazhdojnë të angazhohen me mediat dhe publikun, në mënyrë që të zbatojnë mandatin e tyre dhe të kontribuojnë në promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së shprehjes, mediave dhe informacionit.

Treguesit e nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve

Tërësia e *treguesve të nivelit të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor* janë zhvilluar për të përmbushur nevojat specifike dhe objektivat e shoqatave të gazetarëve për të avokuar për liri më të mëdha të mediave në vendet e tyre dhe për liri e kushte më të mira të punës së gazetarëve. Vitet e fundit, disa organizata ndërqeveritare dhe ndërkombëtare kanë miratuar udhëzime apo metodologji për vlerësimin krahasues të lirisë së mediave dhe sigurisë së gazetarëve në vende të ndryshme. Ndër vlerësimet ose metodologjitë më të njohura janë ato të publikuara nga organizatat e mëposhtme:

- Këshilli i Evropës: *Treguesit e medias në një demokraci*[5]
- UNESCO: *Treguesit e zhvillimit mediatik (MDI)6 dhe Treguesit e sigurisë së gazetarëve: nivel kombëtar*[7]
- USAID – IREX: *Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave*[8]
- Freedom House: *Anketa e lirisë së shtypit*[9]
- BBC World Service Trust: *Iniciativa për zhvillimin e mediave afrikane*[10]

5 *Këshilli i Evropës, Rezoluta 1636 (2008) Treguesit e medias në një demokraci, qasur më 20 tetor 2016: http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17684&lang=en*
6 *UNESCO, Treguesit e zhvillimit mediatik (MDI), vizituar më 20 tetor 2016: http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001631/163102e.pdf*
7 *UNESCO, Treguesit e sigurisë së gazetarëve: nivel kombëtar, qasur më 20 tetor 2016: http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/images/Themes/Freedom_of_expression/safety_of_journalists/JSI_national_eng_20150820.pdf*
8 *IREX, Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave, qasur më 20 tetor 2016: https://www.irex.org/resource/media-sustainability-index-msi-methodology*
9 *Freedom House, Anketa e lirisë së shtypit, qasur më 20 tetor 2016: https://freedomhouse.org/report/freedom-press-2015/methodology*
10 *BBC World Service Trust, Iniciativa për zhvillimin e mediave afrikane, qasur më 20 tetor 2016: http://downloads.bbc.co.uk/worldservice/trust/pdf/AMDI/AMDI_summary_Report.pdf*

- Komiteti për mbrojtjen e gazetarëve: *Dhuna ndaj gazetarëve*[11]
- Reporters without Borders: *Indeksi botëror i lirisë së shtypit*[12]

Përveç metodologjive të listuara, vëmendje e veçantë iu kushtua kornizës strategjike të Komisionit Evropian që ka për qëllim vlerësimin e përmbushjes së qëllimeve politike në fushat e lirisë së shprehjes dhe integritetit të mediave. Kjo kornizë është përmbledhur në *Udhëzimet e DG të Zgjerimit për mbështetjen e BE-së për lirinë e mediave dhe integritetin e mediave në vendet e zgjerimit,, 2014-2020*[13]. Udhëzimet janë me rëndësi kyçe për rrjetin e shoqatave të gazetarëve në rajon, pasi ato kanë marrë në konsideratë problemet e përbashkëta kontekstuale me liritë e mediave në rajon, dhe për këtë arsye sigurojnë bazën për qasjet kombëtare dhe rajonale për trajtimin e problemeve të përbashkëta. Përveç kësaj, rëndësia e këtij dokumenti për shoqatat e gazetarëve vjen nga fakti se ato janë vetë të identifikuara në udhëzime si një nga drejtuesit kryesor të reformave të mediave në rajon.

Marrë në tërësi, metodologjitë e listuara dhe udhëzimet ofrojnë një pikënisje të mirë për të përcaktuar treguesit në përputhje me nevojat dhe prioritetet e AG-ve në Ballkanin Perëndimor. Megjithatë, shumica e tyre janë të dizajnuara për t'u shërbyer objektivave të organizatave ndërkombëtare dhe janë më të fokusuara në zbulimin e të dhënave të krahasueshme kombëtare dhe trendeve të përgjithshme globale mbi liritë e mediave. Për më tepër, ato nuk përshkruajnë një qasje të caktuar metodologjike, duke preferuar të ofrojnë një listë të plotë, nga e cila përshtaten treguesit për veçoritë e kontekstit kombëtar. Tjetra është se ato janë hartuar në demokracitë e zhvilluara perëndimore dhe për këtë arsye u mungon një shkallë e caktuar e përshtatjes së domosdoshme për të pasqyruar kontekstin lokal të mediave në vendet e Ballkanit. Prandaj, duke shqyrtuar të gjitha këto dokumente, janë marrë në konsideratë vetëm ata tregues që mund të reflektojnë perspektivën specifike të AG-ve në avokimin për mbrojtje më të mirë të punës së gazetarëve dhe lirisë në vendet e tyre. Fokusi kryesor është vënë në zbatimin e garancive ligjore të lirisë së shprehjes dhe pavarësisë së mediave, në një sërë faktorësh që pengojnë gazetarët të ushtrojnë lirisht punën e tyre të përditshme në redaksi dhe në kushtet në të cilat gazetarët mund të jenë të sigurt dhe të mbrojtur nga kërcënimet, ngacmimet apo dhuna.

Treguesit për nivelin e lirisë së medias dhe sigurisë së gazetarëve në Ballkanin Perëndimor janë strukturuar në tri kategori, ndërsa secila kategori përbëhet nga një numër i treguesve:

Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve

A.1 A siguron legjislacioni kombëtar garanci për lirinë e mediave dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?

A.2 A shkakton ligji i shpifjes një efekt "trishtues" mes gazetarëve?

A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatave zgjedhore?

A.4 A është liria e punës së gazetarëve e garantuar në ligj?

A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?

11 *Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Dhuna ndaj gazetarëve, qasur më 20 tetor 2016: https://www.cpj.org*
12 *Reporterët pa Kufij, Indeksi botëror i lirisë së shtypit, qasur më 20 tetor 2016: https://rsf.org/index2014/en-index2014.php*
13 *Udhëzimet e DG të Zgjerimit për mbështetjen e BE-së për lirinë e mediave dhe integritetin e mediave në vendet e zgjerimit, 2014-2020, qasur më 20 tetor, 2016: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/elarg-guidelines-for-media-freedom-and-integrity_210214.pdf*

Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?

B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e mediave dhe strukturat udhëheqëse?

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?

B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?

B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?

Siguria gazetarëve

C.1 Siguria dhe statistikat e pandëshkueshmërisë

C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?

C.3 A i trajton me efektivitet sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?

A

Mbrojtja ligjore e lirive të mediave dhe gazetarëve

Në përgjithësi, korniza ligjore mediatike ka garancitë dhe normat themelore për të mbrojtur lirinë e mediave dhe gazetarëve. Ka disa ligje që janë miratuar në lidhje me mediat nga Kuvendi i Kosovës në vitet e fundit. Në këtë raport shprehen mendime se ligjvënësit duhet të përqendrohen në përditësimin e legjislacionit të mediave, për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm të mediave, në veçanti atyre online. Ligjet e reja që duhet të vendosin standarde më të larta, si dhe precedentë, të tilla si ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, ende nuk janë testuar nga gjykatat. Gazetarët ankohen se ligji për qasje në dokumente publike dhe ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë nuk respektohen nga institucionet shtetërore. Ka shembuj të rasteve të përjashtimit nga debati të komunitetit të gazetarëve nga institucionet shtetërore gjatë përgatitjeve të tyre për rregullore të reja që kanë të bëjnë me komunikimin publik.

A.1 A siguron legjislacioni kombëtar garanci për lirinë e mediave dhe a zbatohet me efikasitet në praktikë?

Për shkak të historisë sonë dhe nevojës për rindërtim pas luftës, sistemi ligjor dhe kuadri legjislativ i Kosovës vazhdojnë t'i nënshtrohen një fazë të rindërtimit. Në të njëjtën kohë, në fushën e lirisë së shprehjes, lirisë së mediave dhe informacionit, nga koha e Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), duke vazhduar me pavarësinë dhe pas pavarësisë, është vendosur një kornizë gjithëpërfshirëse.

Kushtetuta e Kosovës garanton lirinë e shprehjes dhe pluralizmin e mediave. Në veçanti, ajo parashikon "të drejtën e shprehjes, shpërndarjes dhe marrjes së informacioneve, opinioneve dhe mesazheve të tjera, pa u penguar."[14] Në mënyrë të ngjashme, e drejta për qasje në dokumente[15] dhe pluralizmi i mediave, duke përfshirë ndalimin e censurës,[16] janë të garantuara. Megjithatë, Kushtetuta pranon se mund të ketë rrethana ku këto të drejta nuk gëzohen në kuptimin e plotë. Kufizime të tilla përfshijnë mundësinë e kufizimit të lirisë së shprehjes me ligj "kur është e domosdoshme për parandalimin e nxitjes dhe provokimit të dhunës dhe armiqësive në baza të urrejtjes racore, kombëtare, etnike ose fetare".[17] Në lidhje me të drejtën e informimit, është e ditur se qasja në informata të caktuara mund të kufizohet me ligj, për shkak të "privatësisë, sekreteve afariste ose sqarimeve të sigurisë"[18] dhe në rastet kur mediat mund të publikojnë informata të pavërteta, jo të plota ose të pasakta, një individ duhet të ketë të drejtën e korrigjimit në përputhje me ligjin.[19]

Standardet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me lirinë e shprehjes, mediave dhe të drejtave të informacionit, siç parashikohet në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, ndër të tjera, janë të garantuara edhe me Kushtetutë.[20] Për më tepër, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) është e rëndësishme nëse të drejtat kushtetuese duhet të interpretohen në përputhje me vendimet e GJEDNJ.[21]

Të tilla garanci ndërkombëtare dhe kushtetuese janë të përforcuara brenda kuadrit ligjor kombëtar përmes një numri të ligjeve të cilat rregullojnë punën e gazetarëve dhe mediave. Një nga ligjet më të fundit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, është ligji për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, i cili ofron garanci ligjore të mëtejshme për gazetarët dhe mediat.

Legjislacioni në lidhje me të drejtën e qasjes në dokumente publike shkoi më tej me miratimin e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale[22] dhe ligjin për klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë[23]. Në vitin 2015, Kuvendi miratoi ligjin e ri për Avokatin e Popullit, duke shfuqizuar ligjin e 2010-ës.

Qasja në internet është e rregulluar me ligjin e ri për komunikime elektronike, i miratuar në vitin 2012, duke shfuqizuar ligjin e 2007-ës. Autoriteti Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare është organi rregullator që zbaton dhe mbikëqyr kornizën ligjore të përcaktuar me këtë ligj.[24]

Teksa kuadri ligjor ofron garanci për lirinë e shprehjes, mediave dhe informacionit, vlerësimi i përgjithshëm i të gjithë gazetarëve dhe ekspertëve të intervistuar është se zbatimi i garancive të tilla ligjore është i dobët. Një nga arsyet e cituara për këtë, është reagimi i ngadaltë i sistemit të drejtësisë në rastet e kërcënimeve dhe sulmeve fizike ndaj gazetarëve.

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), si organizatë kolektive ka përjetuar mungesën e transparencës nga institucionet publike në dy raste, kur u përjashtua nga pjesëmarrja në procesin e zhvillimit të rregulloreve relevante për mediat në Kosovë. AGK dhe KMSHK reaguan kundër përjashtimit të tyre nga zyra e Kryeministrit nga projekt-rregullorja për mbrojtjen e fëmijëve nga ana e mediave.[25] AGK dhe KMSHK u informuan për projekt-rregulloren, pasi iu kërkuar nga zyra e UNICEF-it në Kosovë të komentonin mbi draftin. Të dyja organizatat ishin të mendimit se kjo mungesë e transparencës nuk mund të injorohet dhe abstenuan nga pjesëmarrja, si dhe kërkuan shpjegim nga Zyra e Kryeministrit. Fillimisht, kërkesa për shpjegim u injorua dhe përfundimisht, shpjegimi i dhënë ishte se asnjëra organizata nuk ka rol për të kontribuar në këtë rregullore, çka është penguese dhe jo-transparente.

Mungesa e përfshirjes së organizatave profesionale dhe mungesa e transparencës në proceset e tilla të rëndësishme është dukuri e rregullt në mesin e institucioneve publike. Më parë këtë vit, Këshilli Prokurorial i Kosovës miratoi një rregullore të komunikimit me publikun, edhe pse nuk e përfshiu AGK-në që në fillim të diskutimit të rregullores.

Nuk ka përpjekje nga autoritetet shtetërore për të imponuar licencimin ose kërkesa të tjera për media të shtypura dhe në Internet. Megjithatë, kur themelohen, mediat duhet të zgjedhin një strukturë biznesi, çka kërkon një formë të regjistrimit dhe, në këtë kuptim, hapja dhe regjistrimi i një biznesi nuk është domosdoshmërisht e rëndë, dhe ky regjistrim mund të kryhet në Agjencinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK).[26]

Mediat e shkruara dhe online vetërregullohen nga KMSHK, një organizatë në formë OJQ-je, ku mediat, shtyp apo online, anëtarësohen dhe deklarojnë se

14 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 40 (1)*
15 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41 (1)*
16 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 (1)*
17 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 40 (2)*
18 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 41 (2)*
19 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42 (2)*
20 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 22*
21 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 53*
22 *Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale. I qasshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2676*
23 *Ligji Nr. 03/L-178 për klasifikimin e informatave dhe verifikimin e sigurisë. I qasshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2690*
24 *I qasshëm në: http://www.arkep-rks.org/?cid=2,1*
25 *I qasshëm në: https://www.facebook.com/asociacioniigazetareve/?fref=ts*
26 *I qasshëm në: http://www.arbk.org/en/Home*

veprojnë në përputhje me Kodin e Etikës, që po ashtu i mundëson paraqitjen e ankesës çdo individi që ka shqetësime në lidhje me raportimin mbi atë vetë.

Në të njëjtën kohë, një tjetër aspekt pozitiv i botës online në Kosovë, siç u vu në dukje nga gazetarët dhe ekspertët, është se nuk mund të kujtohet asnjë rast i vetëm kur autoritetet shtetërore janë përpjekur të kufizojnë të drejtën për qasje në internet ose të kërkojnë bllokimin apo filtrimin e përmbajtjes në internet. Kjo ka shume rëndësi kur konsideron popullsinë që e njeh mirë kompjuterin dhe ka qasje në teknologji, pasi i mundëson çdo qytetari marrjen dhe dhënien e informacionit, dhe portalet kanë një rol kyç në këtë proces, me kusht që ato t'i ushtrojnë këto të drejta me përgjegjësi dhe brenda kufijve të ligjit.

Një eksperte e mediave ka thënë se rritja e mediave online ka sjellë një hapësirë shumë më të madhe për lirinë e shprehjes në Kosovë. Ajo pohoi se ankesat e qytetarëve për lajmet kontrollohen nga 20 anëtarët e këshillit të shtypit që vijnë nga mediat online dhe që vendosin nëse ka shkelje të kodit të etikës.

> "Ka një lloj turpërimi mes tyre. Po ashtu, më parë besohej se nuk mund t'i thuhej një gazetari që i ka shpëtuar një pikë. Sot, me praninë e mediave sociale, kushdo ka mundësi të komentojë, ose ta konfirmojë apo ta mohojë një lajm. Në këtë mënyrë, përgjegjësia e gazetarit është pothuajse menjëherë në pyetje."[27]

Në lidhje me mediat audiovizuale, Komisioni i Pavarur për Media (KPM) i Kosovës është autoriteti rregullator që rregullon sferën audiovizuale. Kushtetuta e Republikës së Kosovës i jep përgjegjësi të veçanëtë KPM-së për të rregulluar rrezen e frekuencave të transmetimit në vend, lëshimin e licencave për transmetuesit publikë e privatë, krijimin dhe zbatimin e politikave.[28] Kushtetuta gjithashtu parasheh se "anëtarët e Komisionit të Pavarur të Mediave zgjidhen në një proces transparent".[29] Puna e KPM-së është trajtuar edhe nga korniza legjislative me ligjin e fundit të miratuar në vitin 2012, i cili shfuqizoi ligjin e mëparshëm nga viti 2007.[30] Brenda këtij rregullatori, anëtarët e bordit emërohen nga qeveria dhe votohen në bazë të shumicës nga Kuvendi i Kosovës. Pavarësisht se institucioni ka një rol kyç në realizimin e lirisë së shprehjes, mediave dhe të drejtave të informacionit, emërimet e anëtarëve të bordit konsiderohen gjerësisht të politizuara. Në dhjetor të vitit 2013, dy anëtarë të bordit u shkarkuan për shkak të përfshirjes së tyre në politikë.[31] Ky zhvillim i paralizoi funksionet e KPM-së, pasi e la pa kuorumin e nevojshëm deri në prill të vitit 2014, kur dy anëtarë u emëruan nga Kuvendi i Kosovës, duke e rikthyer këtë organ në gjendje operative. "Nuk besoj se KPM-ja është e pavarur, pasi që anëtarët e tij zgjidhen nga Kuvendi i Kosovës."[32] Përveç kësaj, KPM-ja është kritikuar që nuk ka qenë në gjendje të përmbushë afatin për kalimin në një sistem digjital të transmetimit në Kosovë deri në qershor 2015.

Raporti i IREX-it për Kosovën, mbi menaxhimin e biznesit të mediave, thotë që edhe pse zhvillimi i ngadalshëm ekonomik ndikon edhe në industrinë e mediave, reklamat janë duke u zhvilluar. Megjithatë, "subvencionet e qeverisë, tarifat e abonimeve dhe përdoruesve janë ende problematike."[33] Raporti i Freedom House thotë se institucionet publike në Kosovë u sigurojnë mediave sasinë më të madhe të të ardhurave nga reklamat.[34] Raportet gjithashtu zbulojnë se sigurimi i kontratave me institucionet publike ndikon në politikën editoriale të mediave.

Raporti vjetor 2015 i qeverisë së Kosovës pohon se qeveria ka shpenzuar 1.599.000 euro për marketing.[35] Ministria e Financave nuk ishte në gjendje të tregonte me statistika ku kanë shpenzuar më shumë institucionet. Megjithatë, Ministria e Financave ka deklaruar se mund të ofrojë vetëm shpenzimet e saja për shpallje konkursesh, duke pretenduar se ka shpenzuar 3.855 euro në periudhën janar-shtator 2016.[36]

Megjithatë, ka ministri të tjera që ndajnë një pjesë të buxhetit të tyre për pagesa direkte për media online për shpallje të paguara, të cilat janë vërejtur në disa portale. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka paguar për banera në disa portale, për të reklamuar disa nga aktivitetet e saj. Në mënyrë të ngjashme, Ministria e Punëve të Jashtme ka reklamuar një aktivitet në disa portale. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale ka vendosur të reklamojë në një portal lajmesh si dhe në një agjenci lajmesh. Ministria e Punës ka thënë se "Ministria e punës i paguan 200 euro në muaj "Botapress.info" dhe 400 euro të tjera agjencisë së lajmeve "Kosovapress". Ministria e Bujqësisë tha se ka ndarë 82.690 euro për vitin 2016 nga buxheti i saj për të reklamuar aktivitetet e saja, ndërsa më shumë se gjysma është shpenzuar

27 *Flutura Kusari, eksperte e ligjit të mediave, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016*
28 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 141*
29 *Po aty 11, neni 55*
30 *Ligji Nr. 04/L-044 për komisionin e pavarur për media.*
31 *Lajmi, "Shkarkohen dy anëtarë të KPM-së", Lajmi.net, 26 dhjetor, 2013. Qasur më 11 tetor, 2016: http://lajmi.net/shkarkohen-dy-anetare-te-kpmse/*
32 *Parim Olluri, gazetar, intervistuar më 27 prill, 2016*
33 *IREX, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias 2016, f. 75. Qasur më 11 tetor, 2016: https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2016-kosovo.pdf.pdf*
34 *Freedom House, Liria e shtypit 2015, Qasur më 11 tetor, 2016: https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/kosovo*
35 *Ministria e Financave, raportin vjetor financiar, f. 23. Prishtinë: 2016: http://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/3BAC8FEA-4544-4169-94BA-0D619CF6745C.pdf*
36 *Muharrem Shahini, email drejtuar autorit, 19 tetor, 2016*

deri tani. Ministria ka nënshkruar 39 marrëveshje, nga të cilat 5 janë me gazeta të përditshme dhe 34 me portale online. Në vitin 2011, qeveria vendosi që të gjithë tenderët publikë të reklamohen në faqen e Komisionit të Prokurimit Publik të Kosovës. Në atë kohë, media të shkruara të afërta me qeverinë përfituan dhe arritën të mbijetojnë vetëm përmes këtij lloji të të hyrave.

> "Në atë kohë, dallohej profili dhe orientimi politik i mediave. Për shembull, ishte një gazetë e përditshme "Infopress" që kishte deri në 40 reklama në ditë. Dhe e dimë çfarë lloji profili dhe lajmesh përhapnin ata. Dhe që nga ndalimi i tenderëve publikë në media, ajo gazetë menjëherë u mbyll."[37]

Transmetuesi publik është Radio Televizioni i Kosovës (RTK), i cili rregullohet me ligjin e miratuar në vitin 2012.[38] Transmetuesi publik, i cili financohet nga buxheti i Kosovës, përfshin të gjitha gjuhët e pakicave (serbe, boshnjake, turke dhe rome) në skemën e tij. Pakica serbe ka kanalin e vet RTK 2 që nga qershori 2013.

Dy sulme kundër transmetuesit publik e shënuan këtë vit si më të dhunshmin kundër mediave dhe gazetarëve. Më 22 gusht, 2016, një granatë dore shpërtheu në afërsi të ndërtesës së RTK-së. Sulmi i dytë me granatë pasoi pas një jave, në shtëpinë e drejtorit gjeneral të RTK-së Mentor Shala. Sulmet ndodhën gjatë tensioneve të larta politike në vend.

Autonomia institucionale dhe pavarësia editoriale e transmetuesit publik është e garantuar me ligj[39]. Bordi mbikëqyrës i RTK-së përfaqëson shoqërinë në përgjithësi, duke përfshirë edhe pakicat, por është kritikuar gjerësisht për shkak se nominimet e tyre vijnë nga partitë politike. Gjithashtu, autonomia institucionale dhe pavarësia editoriale e transmetuesit publik kanë qenë subjekt i ndërhyrjeve politike gjatë viteve të fundit. Emërimet politike për pozita editoriale kanë dëmtuar kanalin më të shikuar në vend.[40] Shumë gazetarë të intervistuar besojnë se kolegët e tyre në RTK e dinë paraprakisht se çfarë lloj lajmi nuk do të transmetohet

> "RTK-ja është mediumi më i madh në Kosovë dhe ka paradokse që të befasojnë. Problemi më i madh këtu është autocensura. Pushteti (politik) nuk ka nevojë me të thirr në telefon, sepse ka disa njerëz atje (RTK) që e dinë se ku është kufiri, deri ku mund të shkosh."[41]

Një gazetar anonim tha se ka një praktikë të politikanëve të profilit të lartë, sidomos nga qeveria, që i ftojnë gazetarët e RTK-së të mbulojnë vizitat e tyre jashtë vendit dhe të botojnë lajme pozitive. Shpenzimet për gazetarët mbulohen me para publike.

> "Ata (politikanët) i ftojnë gazetarët me emër për të mbuluar një ngjarje. Qeveria merr përsipër shpenzimet dhe krejt çka i duhet gazetarit është me nga pas vizës. Ka pasur një rast kur një politikan u zemërua me gazetarin e ftuar për mënyrën si u transmetua ngjarja."[42]

Ligji i ri për RTK-në, i cili u miratua në vitin 2012, parashikonte financimin nga buxheti i Kosovës për tre vjet, e më pas pritej të vendosej një tjetër mekanizëm i pavarur financiar. Megjithatë, transmetuesi vazhdon të financohet nga buxheti i Kosovës. Që nga fillimi i këtij viti, marrëveshjet financiare janë lidhur çdo tre muaj. Në një tryezë të rrumbullakët të mbajtur në korrik të vitit 2015, Kryetari i bordit të RTK-së, Ismet Bexheti, ka deklaruar se bordi mbështet financimin nga buxheti i Kosovës.[43] Nga ana tjetër, sindikata i ka dërguar një letër komisionit parlamentar për media duke kërkuar që financimi i RTK-së të bëhet nga qytetarët.[44] Në të njëjtën kohë, Agjencia e Privatizimit e Kosovës (AKP), e cila administron pronat shoqërore të vendit, i ka kërkuar RTK-së të lirojë ndërtesën dhe lokalet tjera, për shkak se pronari i vërtetë është Radio Televizioni i Prishtinës (RTP), i cili ishte televizioni shtetëror i Kosovës para luftës, por nuk transmeton më.[45] Po ashtu, AKP-ja i ka kërkuar RTK-së t'i paguajë qira RTP-së për përdorimin e pronës.

Aktualisht, marrëveshjet e financimit vazhdojnë të ruajnë lidhjen me politikën, tek e cila shumë në këtë fushë nuk kanë besim, pasi shihet si metodë e kontrollit nga ana e qeverive të njëpasnjëshme në lidhje me lajmin e raportuar. Përveç kësaj, raportohen metoda të tjera të favorizimit, qofshin me redaktorë, menaxherë apo gazetarë, çka diskrediton çdo kod të etikës. Teksa transmetuesi publik mund të jetë nën trysni gjatë performancës dhe kohë pas kohe mund të jetë në qendër të sulmeve nga persona të panjohur, qasja e përdorur në dhënien e informacionit është dukshëm e ndryshme nga kanale të tjera të lajmeve, çka lë hapësirë për dyshime në lidhje me pavarësinë e tij dhe lidhjet me qeverinë.

37 *Besnik Boletini, gazetar i OJQ "Çohu", intervistë mbajtur më 27 prill, 2016*
38 *Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës. I qasshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2812*
39 *Ligji Nr 04/L-046 për Radio Televizionin e Kosovës, neni 18*
40 *INDEP, Gjendja e Mediave në Kosovë 2015 (Prishtinë, Kosovë, INDEP, 2015), f. 15*
41 *Artan Haraqija, gazetar i lirë, intervistë e mbajtur më 3 maj, 2016*
42 *Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 10 maj, 2016*
43 *Kaltrina Rexhepi, "Financimi i RTK-së Nga Qeveria Ul Besueshmërinë", Kallxo.com, 1 korrik, 2015. Qasur më 22 tetor 2016*
44 *I qasshëm në: https://web.facebook.com/search/top/?q=sindikata%20sprtk%20profili%20zyrtar*
45 *Erjone Popova, Perparim Isufi "Transmetuesi i Kosovës përballet me kërcënimin e dëbimit", Balkan Insight, 26 maj, 2016, qasur më 2 gusht, 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-public-broadcaster-under-privatization-agency-threats--05-24-2016*

A.2 A shkakton ligji i shpifjes një efekt "trishtues" mes gazetarëve?

Një hap i rëndësishëm ishte dekriminalizimi i shpifjes dhe fyerjes. Ky ndryshim ka sjellë që çdo rast i tillë i hapur kalon vetëm përmes gjykatave civile. Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes rregullon përgjegjësinë ligjore civile për shpifje dhe fyerje.[46] Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se pavarësisht rregullimit me një ligj të vetëm, dekriminalizimit iu desh kohë, pasi kërkoheshin ndryshime në Kodin Penal për të hequr dënimin me burg në qoftë se ka shpifje ose fyerje.[47]

Në vitin 2012, Kodi i ri Penal u miratua dhe ligjvënësit kosovarë hoqën dënimin e mëparshëm me burg për veprat penale të shpifjes dhe fyerjes. Ligji parashikon që kur shpifja ose fyerja pretendohet të ketë ndodhur në një medium, ky i fundit duhet të sigurojë hapësirë për një përgjigje brenda 8 ditëve në vijim të një kërkese të tillë.

Një nga aspektet pozitive të ligjit civil kundër shpifjes dhe fyerjes është se nuk përmban dispozita që janë të rënda ose mbrojtëse për të mirën e zyrtarëve shtetërorë. Në këtë aspekt, ekspertët e mediave thonë se ligji i ri është i pranueshëm, por zbatimi në praktikë mbetet i dobët. Një nga defektet që janë vërejtur me ligjin është se nuk ofron sqarim si mund ose duhet të paraqitet një padi.

> "Është e rëndësishme të përmendet në ligj çfarë mjetesh janë në dispozicion brenda një çështjeje civile, nëse paraqitësi i kërkesës kërkon të mbulojë dëmin ekonomik, ose të padisë për kompensim. Ligji nuk merret me këtë çështje në mënyrë adekuate, duke e lënë në duart e avokatëve të zgjedhin cilëndo mënyrë që ata duan të ndjekin."[48]

Me rëndësi është se ligji parashikon një detyrim ndaj të dëmtuarit për ta zbutur dëmin, duke kërkuar zgjidhje nga botuesi i shprehjes së supozuar shpifëse apo fyese dhe duke paraqitur ankesë në organin përkatës rregullator, si Komisioni i Pavarur për Media (i cili rregullon mediat audiovizuale) dhe Këshilli i Mediave të Shtypuar të Kosovës (autoriteti rregullator i mediave të shtypura dhe online). Duke përfshirë një detyrim të tillë për zbutje brenda ligjit, sigurohet që proceset gjyqësore nuk duhet të jenë konsiderata e parë. Më tej, duke u angazhuar me mekanizma të tillë, ndikimi i mundshëm negativ mbi gazetarët dhe gazetarinë mund të mos jetë shumë domethënës, për shkak se të gjitha palët e interesuara mund të mësojnë përmes një procesi jo kontestues. Ligji kërkon kompensim efektiv dhe të përshtatshëm për personat reputacioni i të cilëve është dëmtuar nga publikimi i materialit shpifës.

Bashkësia e gazetarëve konsideron se ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes do të mbrojë mjedisin e gazetarisë nga mediat që janë të dyshimta dhe nuk kanë të dhëna të pronësisë. Kjo përfshin disa media online që kanë funksionuar për disa kohë dhe tani janë të mbyllura, por kanë publikuar propagandë në emër të grupit të interesit. "Ligji ka nevojë për zbatim. Nuk mund t'i mbrojmë gazetarët që kanë botuar shpifje. Gjithashtu, duhet të tregojmë kujdes kur gjyqtari e respekton pjesërisht ligjin, dhe dënon gazetarët edhe kur nuk ka shpifje."[49]

Në këtë drejtim, është e rëndësishme të theksohet se gazetarët e shohin ligjin si kontribut të rëndësishëm për rritjen e standardeve të gazetarisë, pasi ata presin trajtim të atyre që angazhohen në shkelje, por në të njëjtën kohë ka nevojë të ruhet vigjilenca e të sigurohet se rastet kur padia për shpifje është përdorur në mënyrë të papërshtatshme nuk mbeten të pakundërshtueshëm. Mungesa e pronësisë, sidomos në internet, mund të ketë një ndikim negativ në reputacionin e përgjithshëm të gazetarëve në lidhje me shpifjen, dhe ka raste kur mund ta përdorin si mundësi për t'u angazhuar në shkelje.

Raporti i fundit i Progresit për Kosovën i Komisionit Evropian thekson se liria e mediave dhe e shprehjes garantohet me Kushtetutë, dhe legjislacioni për shpifje, fjalim urrejtës dhe shpifje janë në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, por zbatimi efektiv mbetet sfidë.[50] Megjithatë, një ekspert i ligjit të mediave tha se legjislacioni i përgjithshëm i mediave duhet të përshtatet me zhvillimet e vazhdueshme që ndodhin në mediat online, andaj është e nevojshme të përditësohet legjislacioni. Ligji kundër shpifjes dhe fyerjes nuk është testuar plotësisht në gjykatë, çka do të tregonte nëse ligji është adekuat. "Një faktor tjetër që mungon janë precedentët gjyqësorë. Kjo do të thotë se po të kemi gjykata efektive, legjislacioni do të ishte zhvilluar më tej sipas rasteve gjyqësore. Do të kishte shumë standarde të përcaktuara ku gazetarët do të mund të bazoheshin."[51]

Një konsideratë tjetër e rëndësishme është se ligji parashikon që askush nuk është përgjegjës për shpifje ose fyerje për një deklaratë të cilën gjykata e

46 *Ligji Nr. 02/L-65 ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut 2007/13*
47 *Ligji Nr. 04/L-082 Kodi Penal i Kosovës, 13 korrik 2012 i ndryshuar dhe plotësuar më 9 nëntor 2012 nga ligji Nr. 04/L-129*
48 *Flutura Sheremeti, eksperte e mediave, intervistë e mbajtur më 5 maj, 2016*
49 *Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 3 maj, 2016*
50 *Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën 2015, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf*
51 *Flutura Kusari, eksperte e ligjit të mediave, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016*

vlerëson si deklarim të opinionit, "me kusht që opinioni është shprehur në mirëbesim dhe i bazuar në ndonjë fakt."[52] Për çështje me interes publik ose kur personi i dëmtuar është ose ka qenë zyrtar publik ose është kandidat për post publik, "nuk mund të ketë përgjegjësi për shpifje ose fyerje nëse autori e ka ditur se informacioni ishte i rremë ose ka vepruar duke shpërfillur plotësisht vërtetësinë e tij". Në të gjitha rastet, ligji ndalon çdo kërkesë për të zbuluar një burim konfidencial informacioni. Gjithashtu, ligji thotë se në të gjitha veprimet e shpifjes ose fyerjes, përveç në çështjet e interesit publik, barra e provës bie mbi të pandehurin. Një gazetar tha se paditë për shpifje mund të jenë të vështira për gazetarët, sepse ata duhet të jenë të gatshëm të përfundojnë në gjyq për çdo rast, duke treguar se rasti i ngritur mund të jetë kundër tyre personalisht, e jo kundër botuesit të lajmeve, dhe ky i fundit jo domosdoshmërisht e mbështet gazetarin në procedura ligjore duke i siguruar përfaqësim ligjor.

> "Mund ta padisësh një gazetar në bazë të tre fjalive. Për gazetarët është e vështirë, sepse iu duhet kohë për t'u përgatitur. Ligji civil kundër shpifjes e ka këtë mangësi themelore dhe duhet një debat nëse ka nevojë të ndryshohet. Nëse dikush padit gazetarin për shpifje, gazetari është i detyruar të sjellë në gjyq prova të asaj që është shkruar. Barra e provës u mbetet gazetarëve. Përkundrazi, duhet të jetë paditësi që sjell në gjykatë prova nëse gazetari ka shkruar shpifje."[53]

Aktualisht, në gjykata janë 20 padi kundër gazetarëve me akuzën për shpifje. Nga ky numër, dy padi janë ngritur në gjykatë nga dy deputetë të opozitës kundër dy portaleve online.

Albulena Krasniqi, deputete e Vetëvendosjes, ka nisur procedurat kundër dy portaleve të lajmeve dhe është duke kërkuar kompensim prej 1.5 milionë euro për lajmet e botuara që thoshin se Krasniqi kishte fshehur gaz lotsjellës në organet e saj gjenitale.[54] Krasniqi ka paditur për shpifje të dyja mediat në Prishtinë dhe kërkon 1 milion euro nga Indeksonline dhe 500.000 euro nga Gazeta Express. Rasti ka të bëjë me veprimet e partive opozitare që hidhnin gaz lotsjellës brenda Kuvendit të Kosovës, në shenjë proteste kundër dy marrëveshje të diskutueshme me Serbinë dhe Malin e Zi.

Rexhep Selimi, edhe ky deputet i Vetëvendosjes, ka paditur portalin e lajmeve Gazeta Express për shpifje në lidhje me një dokumentar të quajtur "Selia e milionerëve", në të cilën ata prezantuar pasurinë e komandantëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke pretenduar se ata përfituan pas përfundimit të luftës në vitin 1999 në Kosovë. Selimi, një ish-komandant i UÇK-së, tha se portali është paditur për shpifje dhe nuk ka asgjë të vërtetë në dokumentarin rreth pasurisë së tij.[55]

Ka pesë raste që gazetarët akuzojnë njëri-tjetrin për shpifje dhe fyerje. Pjesa tjetër e rasteve përfshin prokurorë, gjyqtarë dhe avokatë pjesë e lajmeve, që kanë paditur mediat për shpifje. Përveç kësaj, nëntë padi janë hedhur poshtë për shkak të dekriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes në vitin 2012. Gjykatat më të ulëta kanë ndjekur drejtimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila kërkonte që të gjitha rastet për shpifje të trajtohen si çështje civile, si rezultat i dekriminalizimit të shpifjes dhe fyerjes në vitin 2012. Të gjitha këto raste gjyqtarët i kanë hedhur poshtë si të pabaza dhe e kanë mbyllur procedurën penale.

Në bazë të anketës me 50 gazetarë, shumica prej tyre ose 72% (32% + 12% + 28%) tha se ligji për shpifje ka ndikuar (së tepërmi, shumë apo deri diku) në punën e tyre. Duke pasur parasysh se gazetarët mund të përballen personalisht me procese ose që mund të mos mbështeten nga punëdhënësi i tyre me përfaqësimin ligjor, është e vështirë të parashikohet se kjo nuk do të jetë shqetësuese. Përveç kësaj, fakti se proceset ligjore mund të kërkojnë kohë të gjatë për trajtim, për shkak të lëndëve të prapambetura në gjykata, mund të ketë pasoja negative mbi gazetarët. Kjo është për shkak se një punëdhënës mund ta ndërpresë punësimin e atij gazetari në mënyrë të pajustifikueshme, ose mund të ketë ndryshime në lloji e detyrave dhe lajmeve që i lejohen gazetarit.

52 *Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes, neni 8.*
53 *Kreshnik Gashi, gazetar, intervistë mbajtur më 3 maj, 2016*
54 *Erjone Popova, "Deputete kosovare kërkon dëmshpërblim për pretendimet e gazit lotsjellës" (Kosovo MP Seeks Damages Over Tear Gas Claims), Balkan Insight, 24 mars, 2016. Qasur më 23 tetor 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/opposition-mp-sues-two-kosovo-media-for-1-5-m-03-24-2016*
55 *Armend Zenelaj dhe Labinot Leposhtica, "Selimi Dorëzon Padinë Ndaj Shtabit te Milionerëve", 19 gusht, 2016. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/selimi-dorezon-padine-ndaj-shtabit-te-milionereve/*

Tabela 1:
Efekti i ligjit për shpifje në punën e gazetarëve

	Totali
Tepër ndikues	16
Shumë ndikues	6
Disi ndikues	14
Pak ndikues	4
Jo ndikues	7
Jo relevant për punën e të anketuarit	0
Nuk e di	2
Refuzoj	1
Gjithsej	50

A.3 A ka mbrojtje të mjaftueshme ligjore të pluralizmit politik në media para dhe gjatë fushatave zgjedhore?

Në përgjithësi, ekziston pluralizmi i mediave në Kosovë, duke përfshirë mediat transmetuese, të shtypura dhe online. Kushtetuta e Kosovës ofron garanci për pluralizmin e mediave.[56] Ligji për Komisionin e Pavarur të Mediave gjithashtu mbështet liritë dhe pluralizmin e shërbimeve mediatike audio-vizuale në Kosovë.[57]

Prej 2 prillit 2016, Kosova ka 20 stacione televizive, pesë gazeta të përditshme dhe 82 stacione radio.[58] Numri i mediave online mbetet i panjohur, edhe pse portale të reja hapen dhe lansohen në mënyrë të rregullt. Sipas Indeksit të Qëndrueshmërisë së Medias 2016 të IREX-it, ka organizata të caktuara mediatike që perceptohen të jenë të lidhura me agjenda të caktuara politike. "Këto mund të jenë agjenda të qeverisë apo interesa biznesi."[59]

Nuk ka asnjë dispozitë ligjore që detyron mediat në Kosovë në raport me pluralizmin politik në periudhat jo zgjedhore, por kjo çështje është e rregulluar me kod të sjelljes për të gjitha mediat. Kodi i Sjelljes i Komisionit të Pavarur për Media për shërbimet audio-vizuale thotë se shërbimet mediatike audio-vizuale nuk do të promovojnë interesat e një partie politike apo një këndvështrim politik. Kodi rregullon më tej se mediat audio-vizuale nuk do të marrin pjesë në një praktikë që mund të ketë efektin e promovimit të një partie politike duke përjashtuar partitë e tjera politike.

> "Ka pluralizëm politik në mediat e Kosovës. Kur është fjala për transmetuesin publik, ata ftojnë përfaqësues të politikës, i thërrasin për intervista, ka politikanë, janë nga koalicioni qeverisës. Por, kur është fjala për programet e lajmeve, atëherë ka një dallim të madh. Flitet për lajmin që renditet i pari, sa hapësirë u ofrojnë përfaqësuesve politikë."[60]

„Transmetuesi publik e ka kodin e vet të sjelljes që kërkon nga të gjitha programet të jenë politikisht neutralë.[61] "Standardet profesionale dhe parimet e etikës gazetareske në programet e RTK-së" thonë se gaze-

56 *Kushtetuta e Kosovës, neni 42*
57 *Ligji Nr. 04/L-044 për komisionin e pavarur për media, neni 5*
58 *Sipas Komisionit të Pavarur për Media ka 36 operatorë kabllorë dhe 56 ofruesve të shërbimeve të përmbajtjes*
59 *IREX, Indeksi i qëndrueshmërisë së mediave: Kosova 2016, f. 74, vizituar më qershor 22, 2016: https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2016-kosovo.pdf.pdf*
60 *Liridon Llapashtica, ish-gazetar, intervistë e mbajtur më 25 prill, 2016*
61 *RTK, "Standardet Profesionale dhe Parimet e Etikës Gazetareske në programet e RTK-së" http://www.rtklive.com/new/en/etc/RTK_Professional_Standards.pdf*

tarëve dhe redaktorëve nuk u lejohet të preferojnë pozicione politike apo ideologjike të caktuara. Në lidhje me "mbulimin e partive politike", Kodi thekson se RTK-ja nuk është e detyruar, përveç gjatë fushatave zgjedhore, t'u ndajë prani të barabartë partive politike në transmetimet e veta. "Megjithatë, redaktorët duhet të synojnë brenda një periudhe të caktuar (zakonisht jo më shumë se një muaj), t'u japin rëndësinë e duhur të gjitha temave kryesore të argumentit dhe të gjitha partive kryesore. Varet nga gjykimi i RTK-së cilët zyrtarë të partisë dhe anëtarë të tjerë të partisë ftohen për të marrë pjesë në programet e veçanta." Është e paqartë nëse kjo është reflektuar në mënyrë efektive në praktikë, veçanërisht sepse kohë pas kohe RTK merr vendime kaq absurde kur bëhet fjalë për ngjarje me rëndësi publike, të tilla si protestat në kohët e fundit të organizuara nga partitë opozitare apo këndi që i jepet raportimit, saqë në momente të caktuara mund të ketë substancë në argumentin se RTK i paraqet pozitivisht lajme të caktuara apo se qeveria portretizohet në dritë pozitive.

Ligji Zgjedhor rregullon mbulim mediatik gjatë fushatës zgjedhore, dhe kërkon nga të gjitha mediat që të respektojnë Kodin e Sjelljes për Mediat Transmetuese dhe Kodin e Sjelljes për Mediat e Shkruara, siç janë nxjerrë nga Komisioni i Pavarur për Media, në lidhje me të gjitha aspektet e mbulimit dhe reklamave të fushatës.[62]

Të gjitha mediat duhet të sigurohen që të gjitha subjektet politike të certifikuara marrin mbulim të drejtë dhe të barabartë gjatë fushatës elektorale. Të gjitha mediat transmetuese publike emetojnë materiale edukuese për votuesit pa pagesë. Reklamat e partive politike do të jenë jo më shumë se dy minuta, por është e ndaluar të transmetohen reklama në kuadër të programit të lajmeve.

Gazetarët e intervistuar deklaruan se rregullat në fuqi për mediat gjatë periudhës zgjedhore janë të qarta dhe të avancuara, por disa media janë të njohura për rreshtimin me disa parti politike.

> "Ka ngjyra të theksuara në media gjatë periudhës së zgjedhjeve. Ka media të caktuara që përfaqësojnë më mirë disa parti politike, sepse janë të afërt me ta. Mediat fitojnë disa përfitime, qoftë nga qeveria apo bizneset që fitojnë tenderët nga shteti. Këto media vazhdojnë të ofrojë privilegje për partitë politike që drejtojnë vendin."[63]

Komisioni i Pavarur për Media (KPM) monitoron mediat audio-vizuale gjatë fushatave zgjedhore. Është detyrim jo vetëm për transmetuesin publik, por edhe për televizionet private, të japin kohë të barabartë për të gjitha partitë politike. KPM-ja monitoroi mediat gjatë zgjedhjeve të fundit parlamentare të mbajtura në qershor 2014.[64] Në përgjithësi, në raport thuhet se 20 stacionet e monitoruara televizive vepruan në tërësi në mënyrë korrekte dhe të paanshme gjatë fushatës zgjedhore. Monitorimi përfshinte raportimin e lajmeve, debatet, intervistat dhe reklamat e fushatës. Asnjë fëmijë nuk u vu re në reklama. Debatet televizive ofruan kohën e barabartë për të gjithë kandidatët e partive politike.

Mbështetja e pashpallur gjatë zgjedhjeve ndoshta është hallka e dobët, e cila ka potencialin të ndikojë një seksion të gjerë të popullsisë. Kurse përfitimet gëzohen në një fazë të mëvonshme, nëpërmjet përfitimeve dhe favoreve të dhëna. Teksa për momentin nuk ka asnjë precedent në mbështetjen e një partie të caktuar, sidomos në shtypin e shkruar, kjo është një çështje që kërkon analiza dhe diskutime të mëtejshme në mesin e komunitetit të mediave, në mënyrë që të hidhet dritë mbi marrëdhëniet e ngushta që ndërtohen, me përfitime që nuk janë menjëherë të dukshme për votuesit. Kjo është për shkak se votuesve nuk u jepet tabloja e plotë, mund të ndikohen në zgjedhje dhe mund të ndihen të mashtruar, dhe çdo medium që merr pjesë në praktika të tilla nuk e përmbush rolin e tij në dhënien e informacionit në mënyrë të paanshme.

62 *Ligji Nr.03/L-073 për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, Kapitulli VIII, i qasshshëm në: https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2722*

63 *Kreshnik Gashi, gazetar, intervistë mbajtur më 4 maj, 2016.*

64 *http://kpm-ks.org/?mod=dokumentet&faqja=19&gjuha=1*

A.4 A është liria e punës dhe asosiacionit e garantuar dhe e zbatuar në praktikë?

Një aspekt pozitiv i kornizës aktuale ligjore është se gazetarëve në Kosovë nuk u kërkohet të licencohen nga autoritetet shtetërore për të filluar karrierën e tyre në gazetari. Pas diplomimit në universitet, gazetarët e rinj kërkojnë praktika që zakonisht i kryejnë në mediat më të mëdha. Gazetarët thanë se zakonisht nuk ka asnjë marrëveshje ndërmjet praktikantëve dhe pronarëve të mediave. Janë raportuar pak raste kur praktikantët marrin të ardhura, edhe pse kanë tendencë të jenë shumë të ulëta. "Nuk e di sa e drejtë është të mbahen praktikantë për gjashtë ose tetë muaj dhe të mos marrin asnjë pagesë. Në fund, nuk dihet nëse do i marrin në punë. Ose ka disa, që kur punësohen paguhen me 150 euro."[65] Duke qenë se studentët mund të rrezikohen nga shfrytëzimi, veçanërisht në qoftë se mbahen si praktikantë për një kohë të papërcaktuar e pa përfitime, ndërkohë që priten të kontribuojnë si çdo punonjës tjetër, Inspektorati i Punës duhet të jetë më vigjilente për t'u siguruar që rastet e tilla të hetohen.

Përgjithësisht, gazetarëve u lejohet qasje për raportim. Megjithatë, kohë pas kohe disa gazetarë kanë vështirësi ose kufizime në qasjen pa shkaqe të justifikueshme. Një gazetar vuri në dukje se akreditimet e lëshuara nga autoritetet kanë tendencë t'i izolojnë gazetarët në mbulimin e vetëm një institucioni të caktuar shtetëror. "Në një rast, nuk mu lejua të hyj në Kuvendin e Kosovës për shkak se akreditimi im kishte skaduar. Mendoj se nuk duhet të ketë akreditime aspak. Çdo gazetar duhet të kenë qasje të barabartë në institucionet e shtetit."[66]

Nga numri i përgjithshëm i gazetarëve të intervistuar (23 të anketuar nga 50 nuk mund të përgjigjeshin në këtë pyetje, sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari), 61% janë përgjigjur se u kanë refuzuar raportimin nga disa vende apo ngjarje me arsyen se nuk kanë akreditim apo për shkak të kritikave të mëparshme ndaj autoriteteve përkatëse.

Tabela2. A ju është refuzuar ndonjëherë raportimi nga vende apo ngjarje të caktuara në terren me arsyen se nuk keni akreditim të lëshuar nga autoritetet apo për arsye të tjera?

	Totali
Po	16
Jo	10
Nuk e di	1
Refuzoj	0
Gjithsej	27

Gjatë viteve të fundit, pak raste janë raportuar nga gazetarët se u janë refuzuar intervista ose çdo informacion tjetër nga institucionet shtetërore në hakmarrje për raportimin e tyre të mëparshëm kritik. Rasti i fundit iu raportua AGK-së në prill 2016 nga Saranda Ramaj, nga gazeta Koha Ditore, së cilës nuk iu lejua nga kreu i Agjencisë për Produkte Medicinale të Kosovës, Jeton Shala, të raportonte në ditën që kryeministri Isa Mustafa vizitoi agjencinë.[67] Ramaj kishte shkruar më parë disa artikuj në lidhje me parregullsitë në agjencinë e barnave të udhëhequr nga Shala.

AGK gjithashtu dënoi veprimet e Federatës së Futbollit të Kosovës për refuzimin për shumë muaj të informacionit për gazetarin sportiv të gazetës së përditshme "Zëri".[68] Asociacioni ka reaguar edhe kundër vendimit të kryetarit të komunës Suharekë, Sali Asllanaj, që u refuzoi hyrjen dy gazetarëve në fund të konferencës vjetore.

Në përgjithësi, mund të ketë një rritje të transparencës ndaj gazetarëve dhe mediave nga institucionet publike. Për një numër vitesh, Zyra e Kryeministrit ka zgjedhur të mos ketë një zëdhënës ose angazhon një ministër për këtë. Përveç kësaj, kryeministrat janë angazhuar me mediat sociale për të ndarë të reja. Përderisa në njërën anë përdorimi i mediave sociale ofron një metodë më të shpejtë të komunikimit, kur flitet për ndarjen e informacionit nuk arrin ta bëjë këtë në mënyrë të kënaqshme. Përdorimi i metodave të tilla, duke përfshirë mospasjen e një zëdhënësi profesional dhe mungesën e informimeve të rregullta të mbajtura për shtyp, kontribuon në mungesën e transparencës dhe ndalon shqyrtimin efektiv të veprimeve të qeverisë dhe politikave të saj.

Gazetarët janë të organizuar në një organizatë profesionale. Ata janë të lirë të kryejnë aktivitete dhe nuk

65 *Taulant Qenaj, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016*
66 *Kreshnik Gashi, gazetar, intervistë mbajtur më 5 maj, 2016*

67 *Koha Ditore, "AGK: "Pengimi i gazetares së "Kohës Ditore", ngufatje e lirisë së shprehjes" Obstructed journalist of "Koha Ditore", suffocating freedom of expression). Koha Ditore, 12 prill, 2016. Qasur më 8 gusht, 2016: http://koha.net/?id=27&l=107866*
68 *Zëri, "AGK reagon ndaj qasjes së Federatës së Futbollit karshi gazetës Zëri", 5 nëntor, 2015. Qasur më 27 tetor 2016: http://217.172.190.248/sport/60282/agk-reagon-ndaj-qasjes-se-federates-se-futbollit-karshi-gazetes-zeri/*

janë nën trysni. Liria e asocimit është e garantuar në Kushtetutën e vendit, e cila përfshin të drejta për të gjithë për të krijuar një organizatë pa marrë leje.[69] AGK është një nga organizatat kryesore që përfaqëson dhe mbron të drejtat e gazetarëve në Kosovë. Ekziston edhe një shoqatë e mediave të pavarura të transmetimit të Kosovës (AMPEK) që përfaqëson transmetuesit privatë.[70]

Më parë këtë vit, AGK mbajti kuvendin e vet dhe zgjodhi kryetarin e ri të asociacionit dhe anëtarët e rinj të bordit. Për disa vite, asociacioni është ballafaquar me shumë sfida dhe probleme në lidhje me funksionalitetin e tij organizativ. Në maj të vitit 2014, asociacioni mbajti një asamble të jashtëzakonshme, pas pakënaqësisë së gjerë nga komuniteti i gazetarëve me ish kryetarin e asociacionit. Kjo ishte një mundësi e rëndësishme për AGK-në që të konsideronte një sërë ndryshimesh, duke përfshirë edhe statutin dhe zgjatjen e mandatit të nëntë anëtarëve të bordit, duke përfshirë kryetarin, nga dy në tre vjet. AGK gëzon anëtarësi të gjerë dhe ka një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e gazetarëve dhe zhvillimin e standardeve, me më shumë se 400 anëtarë të regjistruar.

Pas riorganizimin e brendshëm, asociacioni ka qenë i përfshirë në debate që lidhen me legjislacionin e mediave dhe aktiv në ruajtjen e të drejtave të gazetarëve. Në vitin 2012, shoqata kërkoi nga qeveria të hiqte tre nene të kontroverse në projekt-kodin penal, në mënyrë të veçantë nenet që e quanin shpifjen si vepër penale dhe lejonin zbulimin e burimit. Përpjekjet e asociacionit për të bashkuar gazetarët ishin të suksesshme dhe rezultuan në miratimin e ndryshimeve që u kërkuan.[71]

Asociacioni ka organizuar edhe disa ngjarje publike. Në tetor 2014, asociacioni ftoi gazetarë dhe përfaqësues të mediave, shoqërisë civile dhe qytetarëve për të protestuar në sheshin kryesor të qytetit. Qëllimi i protestës ishte ngritja e vetëdijes publike në lidhje me dhunën ndaj gazetarëve; në mënyrë të veçantë u tërhoq vëmendja ndaj një rasti kur një gazetar u godit me thikë në vendin e punës.

Vitet e fundit, asociacioni ka organizuar edhe aktivitete për të tërhequr vëmendjen ndaj çështjeve që ndodhin në skenën ndërkombëtare dhe kombëtare. Një nga ngjarjet e organizuara ishte në ndihmë të "Je suis Charlie"[72]. Asociacioni organizoi një ngjarje publike në solidaritet të gazetarëve të vrarë nga sulmi terrorist në zyrat e revistës satirike franceze "Charlie Hebdo", dhe kjo ishte e rëndësishme për kontekstin e Kosovës, për shkak të zhvillimeve në lidhje me ekstremizmin dhe ndikimin që ai mund të ketë në komunitetet dhe lirinë e shprehjes në të ardhmen. Në dritën e mjedisit të brishtë që ekziston kohë pas kohe për gazetarët, AGK ka parë gjithashtu të nevojshme të organizojë ngjarje për të rritur ndërgjegjësimin, tilla si "Fol, mos ki frikë", ngjarje publike për të shënuar Ditën Botërore të Lirisë së Shtypit.

Herë pas here, AGK e ka parë të nevojshme edhe të organizojë veprime më të drejtpërdrejta, si organizimi i një protesta para ndërtesës së qeverisë së Kosovës në lidhje me kërcënimet ndaj gazetarit Vehbi Kajtazi që i raportoi asociacionit se ka marrë një kërcënim nga kryeministri Isa Mustafa . Kajtazi tha se kishte një marrë një telefonatë, përmes Viber, nga kryeministri Mustafa pasi ai botoi një lajm që ishte në lidhje me vëllanë e kryeministrit. Lajmi që lidhej me migrimin masiv nga Kosova në vitin 2015 drejt vendeve të Evropës perëndimore, raportonte se vëllai i kryeministrit ishte një nga shumë kosovarët që kërkonin azil në Gjermani. Kryeministri Mustafa përdori gjuhë ofenduese ndaj Kajtazit dhe e kërcënoi. Kajtazi e raportoi rastin në polici.[73]

Gjatë vitit 2016, AGK dënoi kërkesën e Ambasadës turke në Prishtinë ndaj autoriteteve të Kosovës për të ndërmarrë veprime ligjore kundër gazetarit Berat Buzhala, i cili kritikoi presidentin turk Reccep Tayyip Erdogan në mediat sociale. Në 15 korrik, gjatë grushtit të shtetit në Turqi, Buzhala shkroi një koment satirik në Facebook, duke u bërë thirrje të gjithë kosovarëve që po kalonin pushimet në Turqi që të mbështesnin ushtrinë.[74] Komenti ishte nënshkruar me një emoticon me gjuhën jashtë. Ambasadori turk në Kosovë i dërgoi një notë Ministrisë së Jashtme të Kosovës duke kërkuar veprim ligjor ndaj Buzhalës. Nota e ambasadorit përmendte ligjin e sapo miratuar në Kosovë, i cili u ndalon qytetarëve të bashkohen me konfliktet e huaja të armatosura. Asociacioni i kërkoi Ambasadës Turke në Prishtinë të kërkonte ndjesë, si dhe shkarkimin e ambasadorit nga Kosova, pasi komenti satirik ishte brenda kufijve të lirisë së shprehjes, nuk kishte lidhje me një vepër penale, si dhe ishte e pazakontë që një ambasador t'u bëjë thirrje të tilla autoriteteve lokale. Ministri i Jashtëm i Kosovës, Enver Hoxhaj, tha se nota e Ambasadës Turke në Kosovë është e papranueshme dhe e pazakontë.

AGK beson se është e rëndësishme të kapitalizojë mbi sukseset e veta dhe të forcojë kapacitetet në mënyrë

69 *Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 42*
70 *I qasshëm në: http://ampek.org/*
71 *I qasshëm në: http://kallxo.com/gjnk/largohen-nenet-37-e-38-nga-kodi-penal/*
72 *Grup autorësh, "Zi për viktimat e sulmit të terrorit në Paris në Ballkan." Balkan Insight, 8 janar, 2015. Qasur më 21 tetor 2016*

73 *Erjone Popova, "Gazetari kosovar denoncon kërcënimet e pretenduara të kryeministrit", Balkan Insight, 22 mars, 2016. Qasur më 4 gusht, 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-journalists-protest-against-prime-minister-s-threats-03-22-2016*
74 *Taulant Osmani, "Gazetarët dënojnë kërkesën e Turqisë për të ndëshkuar gazetarin kosovar për shkak të komenteve të grushtit të shtetit", Prishtina Insight, 7 korrik 2016. Qasur më 4 gusht, 2016: http://prishtinainsight.com/journalists-condemn-turkeys-request-punish-kosovo-journalist-coup-comments/*

që të jetë më mirë e përgatitur për të reaguar ndaj një mjedisi gjithnjë në ndryshim, çka nuk është gjithmonë progresive për gazetarët. Kjo përfshin punën me shoqata të tjera të gazetarëve. Asociacioni iu bashkua dy federatave të gazetarëve, Federatës Evropiane të Gazetarëve[75] dhe Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.[76]

Garancitë për lirinë e asocimit për të punësuarit dhe punëdhënësit janë dhënë me Kushtetutë dhe me ligjin e punës. Ky i fundit shprehet se liria është e garantuar pa asnjë ndërhyrje nga ndonjë organizatë tjetër apo organ publik.[77] Përveç kësaj, ekziston një ligj i veçantë që rregullon të drejtat dhe lirinë e sindikatave në sektorin privat dhe publik.[78] Deri më sot, në Kosovë nuk ka sindikata për interesat e gazetarëve. Megjithatë, ka sindikata të tjera për të punësuarit në kuadër të transmetuesit publik, të tilla si Sindikata e Pavarur e RTK-së (SPRTK) dhe Sindikata e punëtorëve të RTK-së.

Gjatë viteve të fundit, SPRTK-u, sindikata më e vjetër në RTK, ka organizuar disa protesta[79] kundër abuzimit dhe nepotizmit të menaxhmentit. Më tej, redaktorët dhe gazetarët e lajmeve organizuan një protestë kundër shkarkimit të kryetarit dhe nën-kryetarit të sindikatës nga menaxhmenti i RTK-së. Të dy drejtuesit u kthyen në pozitat e tyre.

Sindikatat kanë kërkuar edhe një hetim për shpenzimin e buxhetit të RTK-së nga menaxhmenti. Në maj 2016, zëvendës kryetari i sindikatës, Arsim Halili, i cili është gjithashtu redaktor, u shkarkuar nga puna e tij si redaktor, për të dytën herë brenda një periudhe të shkurtër kohe, për shkak të një statusi të Halilit në rrjetin e mediave sociale Facebook. Drejtori gjeneral kërkoi pezullimin e menjëhershëm të Halilit, për shkak të vërejtjeve të tija fyese në mediat sociale ndaj komunitetit LGBT. Disa e panë këtë si hakmarrje ndaj aktivizmit sindikal të Halilit. Në prill 2015, menaxhmenti shkarkoi Halilin si dhe kryetarin e sindikatës, Fadil Hoxhën, për shkelje të supozuar të politikave editoriale. Pak ditë më vonë, inspektorati i punës urdhëroi rikthimin e Halilit dhe Hoxhës në vendet e tyre të punës.

Pavarësisht kuadrit ligjor ekzistues që siguron të drejtat e sindikatave, është e qartë se kjo e drejtë nuk gëzohet plotësisht në sektorin privat. Mjedisi aktual ekonomik, i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në media, i lë gazetarët në sektorin privat të ekspozuar, pasi ata nuk kanë shumë fuqi negocimi. Në të njëjtën kohë, zbatimi i dobët i ligjit të punës kontribuon në status quo. AGK-ja, si dhe sindikatat, duhet të vazhdojnë të angazhohen në këtë fushë, në mënyrë që të sigurohet zbatim më i mirë në të ardhmen dhe të drejtat sindikale të gëzohen nga të gjithë.

KMSHK u themelua në vitin 2005 dhe ka 20 anëtarë nga media të shtypura dhe online. Një nga kriteret për anëtarësim në KMSHK është që mediat duhet të paraqesin të dhënat e pronësisë.[80] Deri më sot, ka krijuar reputacion në trajtimin e ankesave nga individë apo organizata, edhe pse mund ta rrisë më tej ndërgjegjësimin në lidhje me rolin e vet, duke u mundësuar më shumë anëtarëve të publikut të kërkojnë zgjidhje.

75 Koha Ditore, "Asociacioni i Gazetarëve i bashkohet Federatës Evropiane të Gazetarëve." Koha Ditore, 8 qershor, 2016. Qasur më 10 tetor 2016 http://koha.net/?id=1&l=102745

76 Kosova Press, "Journalists Association of Kosovo joins International Federation of Journalists." "Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës është anëtarësuar në Federatën Ndërkombëtare të Gazetarëve", Kosova Press, 8 qershor, 2016. Qasur më: 10 tetor, 2016: http://www.kosovapress.com/sq/lajme/agk-pranohet-ne-federaten-nderkombetare-te-gazetareve-75202/

77 Ligji Nr.03/L-212 i punës, neni 88

78 Ligji Nr. 04/L-011 për organizimin e sindikatave në Kosovë

79 Koha Ditore, "Sindikata tërheq vërejtjen për nepotizëm në RTK", Koha Ditore, 14 gusht, 2014. Qasur më 14 tetor 2014: http://koha.net/?id=27&l=21548

80 Statuti i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës, Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, Modifikuar për herë të fundit me 23 tetor, 2016

A.5 Cili është niveli i mbrojtjes ligjore të burimeve të gazetarëve?

Një tjetër zhvillim i kohëve të fundit është miratimi i ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.[81] Ai përmban vetëm dhjetë nene dhe zbatohet për gazetarët dhe profesionistët e tjerë të mediave që janë të angazhuar në mbledhjen, përpunimin dhe shpërndarjen e informacionit nëpërmjet mediave. Sipas ligjit, gazetarët dhe profesionistët e mediave kanë të drejtë të heshtin në lidhje me burimet e tyre të informacionit. Gazetarët detyrohen t'i zbulojnë burimet e informacionit vetëm me urdhër të gjykatës, kur e nevojshme për të parandaluar kërcënim serioz që do të çonte në vdekjen e një apo më shumë personave.

Më tej, ligji ndalon bastisjen e ndërtesave të kompanive mediatike dhe pronave të tjera të mediave, të tilla si makina apo shtëpitë e gazetarëve, në qoftë se është ndonjë masë e hetimit që ka për qëllim të identifikojë burimin e informacionit. Ky është një zhvillim i rëndësishëm, sepse fillimisht çështja e burimeve adresohej përmes Kodit Penal. Megjithatë, pas një numri protestash u eliminuan kufizimet e pajustifikueshme e të dëmshme për gazetarët në përmbajtjen e mediave në lidhje me burimet.

Kodi Penal ishte një nga ligjet kyç në lidhje me mbrojtjen e burimeve të gazetarëve. Plotësimi e ndryshimi i tij u zhvillua në vitin 2012, dhe u hartua nga Ministria e Drejtësisë. Megjithatë, duke qenë se vazhdohej me kriminalizimin e shpifjes, e sidomos kishte përkufizime se kush mund të përballet me sanksione penale, komuniteti i gazetarëve dhe shoqëria civile u bashkuan dhe fushatë që këto tre nene të kodit të ndryshoheshin, pasi kompromotonin lirinë e mediave dhe sigurinë e gazetarëve.

Në veçanti, komuniteti ishte kundër nenit 37 që vazhdonte të sanksiononte shpifjen dhe nenit 38 në lidhje me zbulimin e burimit të informacionit në rastet e proceseve penale.[82] Pas një fushate të suksesshme, ligjvënësit i ndryshuan nenet duke dekriminalizuar shpifjen, si dhe duke hequr ato pjesë që kanë të bëjnë me mbrojtjen e burimeve të gazetarëve. Heqja e plotë e mbrojtjes së burimeve nga Kodi Penal e la këtë çështje disi të parregulluar. Megjithatë, ky vakuum u plotësua kur Kuvendi i Kosovës miratoi ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë[83]. Ky ligj ka për qëllim sigurimin e mëtejshëm të sigurisë së gazetarit, konfidencialitetit të burimeve dhe mjedisit mediatik në përgjithësi. Gazetari është i obliguar ta zbulojë burimin vetëm me kërkesë të një gjykate kompetente, dhe vetëm nëse "zbulimi i identitetit të burimit të informacionit është i nevojshëm për të parandaluar një kërcënim serioz për integritetin fizik që mund të çojë në vdekjen e një ose më shumë personave"[84].

Testi i vërtetë i ligjit aktual do të jetë kur kërkesa për zbulim nga ana e autoriteteve të bëhet përmes kanaleve të duhura dhe në rastet kur gazetarët janë në gjendje t'i kërkojnë gjykatave shqyrtim nëse zbulimi do të ishte i lejuar. Në dritën e vonesave që vazhdojnë të jenë të pranishme në sistemin e drejtësisë, dyshohet nëse ky lloj udhëzimi mund të sigurohet në të ardhmen.

Në të njëjtën kohë, nuk është se kërkesat për zbulim nuk janë bërë tashmë. Gjatë intervistave të thelluara, janë përmendur raste sporadike kur gazetarët janë vënë nën presion që të zbulojnë burimet e tyre, pa urdhër të gjykatës. Shembuj konkretë tregojnë se konfidencialiteti i burimeve të informacionit të gazetarëve nuk respektohet.

Një nga rastet është i Faton Shoshit,[85] pronari i portalit "Indeksonline", që pretendon së është kontaktuar nga një zyrtar i lartë nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI), Valon Salihu, i cili dyshohet se kërcënoi Shoshin pasi ai botoi një artikull në lidhje me drejtorin e AKI-së. Shoshi pretendon se ai ishte nën trysni nga Salihu që të takohej me drejtorin e AKI-së. Takimi nuk ndodhi, pasi zyrtari i AKI-së dalloi se ndiqej nga kolegët e Shoshit. Gazetari e raportoi rastin në polici. Në gusht të vitit 2014, prokuroria në Prishtinë lëshoi një aktakuzë kundër Salihut dhe në qershor 2015 seanca gjyqësore u anulua nga gjyqtari për shkak të mungesës së të paditurit.

Në një rast tjetër, Astrit Gashi, gazetar i portalit "Blic", pretendon të jetë kërcënuar përmes telefonit nga drejtori i Njësisë së Hetimeve Financiare[86], Dardan Nuhiu, pasi portali publikoi një dokument të rrjedhur konfidencial të NJIF-it. Pretendohet se Nuhiu kërcënoi Gashin duke i treguar pasojat që do të ndiqnin publikimin.

Gazetarët besojnë se oficerët e policisë dhe institucionet e tjera shtetërore duhet të trajnohen për ta kuptuar më mirë këtë dhe ligje të tjera që kanë të bëjnë me të drejtat e gazetarëve në përgjithësi. "Në këtë aspekt, ka

81 *Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.*
82 *Koha Ditore, "Të gjithë kundër neneve 37 dhe 38 të Kodit Penal". Koha Ditore, 23qershor, 2016. Qasur më 10 tetor 2016: http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=104515*
83 *Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.*
84 *Po aty, neni 5*
85 *Telegrafi, "Shoshi: AKI tried to kidnap me." "Shoshi: AKI tentoi të më kidnapoi". Telegrafi.com, 4 dhjetor, 2013. Qasur më 10 tetor 2016: http://www.telegrafi.com/shoshi-aki-tentoi-te-me-kidnapoi/*
86 *Kosova Press, "AGK kërkon të nisin procedurat disiplinore kundër Dardan Nuhiut". 4 prill, 2016. Qasur më 5 gusht, 2016: http://www.kosovapress.com/sq/lajme/agk-kerkon-pergjegjesi-nga-nuhiu-per-kercenimin-ndaj-gashit-39641/*

një mungesë të vetë-ndërgjegjësimit të policisë, prokurorisë dhe institucioneve të tjera. Atyre nuk u lejohet t'i kërkojnë burimin gazetarit".[87] Në dritën e zhvillimeve të fundit që kanë ndodhur, trajnimi mund të jetë një mjet i dobishëm për t'i diskutuar këto ndryshime dhe për ta sjellë në vëmendjen e bartësve obligimin e tyre. Përveç kësaj, mund të jetë e nevojshme që të ketë procese brenda institucioneve të ndryshme në mënyrë që çdo kërkesë të bëhet në mënyrë zyrtare dhe të jetë e bazuar, duke kufizuar ndikimin e trysnisë nga institucione të veçanta, në qoftë se do kishin këtë qasje në trajtimin e burimeve. Gjykatat do të kenë një rol të rëndësishëm duke treguar qasjen, disponueshmërinë dhe aftësinë për t'u marrë me raste të tilla menjëherë.

Në të njëjtën kohë, shumica e gazetarëve të intervistuar përmes anketës janë përgjigjur se ndihen të lirë të mbajnë kontakte me burimet e informacionit gjatë raportimit mbi çështjet e interesit publik.

Shumica e gazetarëve të anketuar janë përgjigjur se ndihen të lirë të mbajnë kontakte me burimet e informacionit gjatë raportimit mbi çështjet e interesit publik. Gazetarët e anketuar (44.4%) thanë se ndërveprimi me burime, identiteti profesional i të cilëve duhet të respektohet, është rritur disi. (23 të anketuar nga 50 nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari).

Tabela3. Ndërveprimet e gazetarëve me burime fshehtësia profesionale e të cilëve duhet të respektohet.

	Totali
Rritur shumë	7
Rritur disi	12
Nuk ka ndryshuar	7
Ulur disi	0
Ulur shumë	0
Nuk e di	1
Refuzoj	0
Gjithsej	27

87 *Flutura Kusari, eksperte e ligjit të mediave, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016*

A.6 Cili është niveli i mbrojtjes së të drejtës për qasje në informata?

Ligji për qasje në dokumente zyrtare është miratuar në vitin 2010, duke shfuqizuar ligjin e vitit 2007, të bazuar në një rregullore të vitit 2003 të shpallur nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë, nën mbikëqyrjen e misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, UNMIK.[88] Ndryshimet e fundit në ligji kanë sjellë ndryshime të rëndësishme, duke përfshirë shkurtimin e disa afateve për institucionet shtetërore për t'iu përgjigjur kërkesave për informacion nga 15 ditë në 7.

Përveç kësaj, në vitin 2012, qeveria e Kosovës lëshoi një rregullore për provat zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike.[89] Rregullorja kërkon nga të gjitha institucionet shtetërore të ndjekin të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike dhe të dorëzojnë raportin në zyrën e Kryeministrit për të nxjerrë një raport vjetor. Një rregullore tjetër u miratua në vitin 2012, për tarifat e kërkesave për qasje në dokumente publike.[90] Ka disa tarifa që duhet të paguhen në lidhje me kërkesat për të mbuluar shpenzimet për të prodhuar dokumente dhe kopje. Ka përjashtime të kufizuara nga tarifat, edhe nëse informacioni dërgohet në mënyrë elektronike ose informacioni mund të sigurohet me një numër të kufizuar të faqeve.

Duke qenë ligj i rëndësishëm për gazetarët, ata dominojnë në kërkesat që u bëhen institucioneve publike, por ata ankohen për mungesë të qasjes në dokumente publike nga autoritetet shtetërore që janë relevante për raportimin e tyre.[91] Shqetësime të ngjashme janë shprehur nga organizatat relevante ndërkombëtare.[92]

> "Ka një tendencë të vazhdueshme nga pushteti qendror dhe lokal të qëndrojnë të mbyllur për publikun dhe mediat. Ka një një ligj për qasje në dokumente publike, por ne gazetarëve jo vetëm që na privohet qasja në dokumente, por as nuk na sigurojnë një minimum të informacionit."[93]

Kur mohohet qasja në dokumente, kërkuesi mund të paraqesë ankesë në zyrën e Avokatit të Popullit. Megjithatë, vetëm dy ankesa janë paraqitur tek Avokati i Popullit

88 *Ligji Nr. 03/L-215 për qasje në dokumente publike*
89 *Rregullorja Nr. 04/2012 mbi provat zyrtare të kërkesave për qasje në dokumente publike*
90 *Rregullorja Nr. 02/2012/MF mbi tarifat për qasje në dokumente publike*
91 *Intervista të thelluara me 11 gazetarë dhe dy ekspertë të mediave*
92 *Komisioni Evropian, Raporti i Progresit për Kosovën 2015, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf*
93 *Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016*

Tabela 4. Sa transparencë demonstrohet nga institucionet e mëposhtme?

	Kuvendi i Kosovës		Qeveria e Kosovës		Partitë politike		Politikanët në përgjithësi		Gjyqësori/ gjykatat		Policia		Forcat e sigurisë	
	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%	Nr.	%
transparencë e plotë	2	7,41	2	7,41	0	0,00	1	3,70	0	0,00	1	3,70	2	7,41
shumë transparent	6	22,22	0	0,00	2	7,42	1	3,70	1	3,70	6	22,22	5	18,52
disi transparent	12	44,44	11	40,74	6	22,22	5	18,53	13	48,15	13	48,16	10	37,04
pak transparent	5	18,53	10	37,04	12	44,44	10	37,04	10	37,04	4	14,81	3	11,11
aspak transparent	1	3,70	3	11,11	6	22,22	9	33,33	2	7,41	2	7,41	3	11,11
Nuk e di	1	3,70	1	3,70	1	3,70	1	3,70	1	3,70	1	3,70	3	11,11
Refuzoj	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0	0,00	1	3,70
Totali	27		27		27		27		27		27		27	

gjatë dy viteve, 2008 dhe 2009[94], dhe 33 gjatë vitit 2015, por vetëm 23 qenë të pranueshme.[95] Të gjitha ministritë kanë emëruar zyrtarët për t'u marrë me kërkesat.

Gazetarët pohuan se qeveria, partitë politike dhe gjykatat demonstrojnë pak transparencë. 77,78 për qind e gazetarëve thanë se Qeveria e Kosovës tregon disi ose pak transparencë. Situatë e ngjashme është me gjyqësorin - 85,19 për qind e gazetarëve thanë se gjykatat tregojnë disi ose pak transparencë, ndërsa askush nuk tha se gjykatat tregojnë transparencë të plotë.

Kuvendi i Kosovës konsiderohet të jetë më transparent se institucionet e tjera. 22,22 për qind e gazetarëve tha se parlamenti tregon shumë transparencë, ndërsa 7,41 për qind tha se parlamenti tregon transparencë të plotë.

Zyra e Kryeministrit mbledh të gjitha të dhënat dhe nxjerr një raport vjetor. Raporti i vitit 2015 pohon se 1.960 nga 2.132 kërkesa, ose 91% e të gjitha kërkesave, kanë marrë qasje në dokumente publike.[96] Në raport thuhet se 116 kërkesa janë refuzuar dhe 56 kërkesave u është lejuar qasje e kufizuar.

Gazetarët kanë bërë numrin më të madh të kërkesave në institucionet shtetërore (34%), pasuar nga individët me 23%. Zyra e Kryeministrit, ministritë dhe agjencitë e tjera të varësisë kanë marrë gjithsej 887 kërkesa (41%). Gjatë vitit 2015, më shumë se gjysma, përkatësisht 54,61 për qind e kërkesave për qasje në dokumente të paraqitura në Qeverinë e Republikës së Kosovës ishin për dokumente që përmbajnë statistika, 17,30 për qind kanë të bëjnë me dokumentet që përmbajnë të dhëna buxhetore ose të shpenzimeve, ndërsa 12,02 për qind e kërkesave janë të lidhura me vendimet e marra. Kërkesat e paraqitura në qeverinë e Kosovës kërkojnë qasje në statistika, të dhënat e shpenzimeve dhe vendime.

Shumë gazetarë thanë se qeveria dhe ministritë zakonisht nuk iu përgjigjen kërkesave të tyre për qasje në dokumente zyrtare. "Kuvendi i Kosovës është i hapur në një shkallë. Por, qeveria që duhet t'i zbatojë ligjet, është e mbyllur dhe nuk lejon qasjen në dokumente publike. Në disa raste, përgjigjet vonohen shumë, ndonjëherë duhen muaj."[97]

Një gazetar i intervistuar deklaroi se ligji duhet të përfshijë një mekanizëm që do t'i vinte nën trysni ato institucione shtetërore që nuk japin qasje në dokumente zyrtare, dhe disa nga ekspertët ligjorë ofrojnë argumentim shtesë për këtë.

> "Ka një tendencë të vazhdueshme nga pushteti qendror dhe lokal të qëndrojnë të mbyllur për publikun dhe mediat. Ka një një ligj për qasje në dokumente publike, por ne gazetarëve jo vetëm që na privohet qasja në dokumente, por as nuk na sigurojnë një minimum të informacionit."[98]

Një gazetar tha se ligjit për qasje në dokumente zyrtare i mungon kualifikimi dhe klasifikimi i dokumenteve zyrtare, çka paraqet një problem të madh për institucionet shtetërore, kur kanë të bëjnë me kërkesat formale. Në një rast, Ministria e Jashtme e vonoi qasjen për tre muaj[99].

Në vitin 2014, BIRN-i ka raportuar se institucionet e Kosovës u janë përgjigjur 40 përqind të 125 kërkesave për qasje në dokumente publike.[100] Kërkesat u

94 GAP, Qasja në Dokumente Publike, Seria e Hulumtimeve Parlamentare, Prishtinë: 2010, f. 6. Qasur më 10 tetor 2016: http://www.institutigap.org/documents/65564_AccessDocuments.pdf,
95 Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë, Raporti Vjetor 2015 Prishtinë: 2016, f. 37, qasur më 23 tetor 2014: http://www.ombudspersonkosovo.org/repository/docs/Raporti_Vjetor_2015_IAP_FINAL_351292.pdf
96 http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/2015_ANG.pdf

97 Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 3 maj, 2016
98 Po aty, 20
99 Po aty, 10
100 BIRN, Raporti për Qasje në Dokumente Publike 2013-2014, Prishtinë: 2013. Qasur më 6 gusht, 2016: http://www.drejtesianekosove.com/repository/docs/report_on_access_to_public_documents_2013-2014_824655.pdf

ishin dërguar Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive të ndryshme, zyrës së Presidentit dhe bordit të Agjencisë së Privatizimit. Raporti thekson se asnjë nga kërkesat nuk mund ekspozonte sigurinë kombëtare, sekretin shtetëror ose ndonjë hetim në zhvillim e sipër.

Po ashtu, ligji nuk parashikon sanksione, por i siguron palës që kërkon informim të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente. Procesi gjyqësor mund të marrë kohë dhe të jetë i kushtueshëm, megjithatë, ndryshimet në qëndrimet dhe praktikat e punës mund të bëhet vetëm nëse vendosen precedentë. Për çdo refuzim, gazetarët duhet të angazhojnë në radhë të parë institucionin e Avokatit të Popullit. Megjithatë, duke pasur parasysh se vetëm 23 ankesa janë pranuar nga Avokati i Popullit në vitin 2016, dyshohet që kjo të jetë kthyer në praktikë standarde në mesin e gazetarëve. Ndërkohë që duhet të pranohet se paraqitja e ankesave, qofshin në proces kontestimor ose jo-kontestimor, kërkon shumë kohë, zbatimi është më i mirë vetëm nëse të gjitha palët janë të gatshme për t'u angazhuar me procesin.

Një shembull i ndikimit pozitiv që mund të sjellë angazhimi për zgjidhje është kontesti i BIRN-it. Ai ka fituar dy beteja ligjore, një kundër zyrës së Kryeministrit të Kosovës dhe e dyta kundër Këshillit Prokurorial. Në tetor 2015, një gjykatë në Prishtinë vendosi se zyra e kryeministrit duhet t'i zbulojë shpenzimet për publikun.[101] Kërkesa për dokumente publike nga zyra e kryeministrit lidhej me shpenzimet e udhëtimeve jashtë shtetit të ish-kryeministrit të Kosovës Hashim Thaçi, i cili tani shërben si President i vendit. Kërkesa me informacion të njëjtë iu dërgua edhe gjashtë zëvendëskryeministrave dhe katër zëvendësministrave të qeverisë aktuale Mustafa. Zyra e kryeministrit mohoi qasjen në informacione të tillë duke argumentuar se faturat për ushqim dhe pije mund të zbulojnë informacione fetare dhe dietetike për individët. Megjithatë, gjykata nuk u pajtua dhe urdhëroi që një informacion i tillë është në interes të publikut dhe duhet të shpaloset.

Rasti i dytë ligjor përfshiu Këshillin Prokurorial të Kosovës, i cili refuzoi kërkesën e BIRN-it për qasje në dokumente publike në lidhje me vendimet disiplinore të Këshillit.[102] Gjykata në Prishtina vendosi se Këshilli Prokurorial duhet t'i shpalosë dokumentet që lidhen me masat disiplinore për shkelje të marra ndaj prokurorëve.

Të dhënat e mbledhura përmes anketës tregojnë se duhet këmbëngulje që të ketë ndryshime. 78% e të anketuarve konfirmuan se institucionet kanë refuzuar t'u sigurojnë dokumentet e kërkuara. Të anketuarit deklaruan se dokumentet e kërkuara në institucionet shtetërore kanë qenë të nevojshme për raportimin e tyre. (23 të anketuar nga 50 nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari).

Tabela 5. A ju kanë refuzuar ndonjëherë autoritetet publike qasjen në informata publike të nevojshme për raportimin tuaj?

	Totali
Nuk kam kërkuar kurrë qasje në informata publike	2
Kam kërkuar qasje në informata publike, por nuk ma kanë refuzuar kurrë	3
Kam kërkuar qasje në informata publike, dhe ma kanë refuzuar	21
Nuk e di	0
Refuzoj	1
Total	27

101 http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-wins-legal-case-against-kosovo-pm-s-office-10-29-2015
102 http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-legal-victories-set-precedent-for-transparency-07-19-2016

B

Pozicioni i gazetarëve në redaksi, etika profesionale dhe niveli i censurës

B.1 A abuzohet me pozitën ekonomike të gazetarëve për të kufizuar lirinë e tyre?

Gjendja e keqe ekonomike në Kosovë ka pasur efektet e saja negative edhe në media. Problemi më i madh për mediat në Kosovë mbetet qëndrueshmëria e tyre financiare, për shkak se shumica e organizatave të mediave varen nga të ardhurat e marketingut.[103] Gjatë intervistave, gazetarët deklaruan se mungesa e kontratave të punës është një nga metodat kryesore të përdorura nga pronarët e mediave për të ushtruar trysni mbi ta: Problemi numër një është mungesa e kontratave të punës. Një pjesë e madhe e gazetarëve punojnë pa kontrata. Gazetarët ndihen të pasigurt, sepse ata mund t'i humbasin punët brenda ditës."[104]

Derisa ky dokument është baza e marrëdhënies së punës, mungesa e kontratës mund të krijojë një numër problemesh, duke përfshirë pasiguri dhe mungesë të mbrojtjes në lidhje me trajtimin në vendin e punës, pagat nuk paguhen në kohë ose iu mbahen, të drejtat e pushimit nuk iu njihen, mungojnë të drejtat e pensionit. Mospasja e një dokumenti themelor do të thotë se çështje të tjera si paketa e përfitimeve as nuk konsiderohen. Për shembull, gazetarët ka shumë të ngjarë të mos kenë ndonjë lloj të

103 OSBE, Liria e Mediave dhe Siguria e Gazetarëve në Kosovë, Prishtinë: 2009, f.15. Qasur më 10 tetor 2016: https://www.osce.org/kosovo/122390?download=true
104 Besnik Boletini, gazetar, intervistuar më 27 prill, 2016

sigurimit shëndetësor ose të mbrojtjes sociale, si pushimi mjekësor i paguar. Një tjetër shqetësim i ngritur nga gazetarët është se edhe ata përballen me sfida financiare, sidomos kur pagat e tyre paguhen me vonesë.

> "Ka gazetarë që u kanë borxh deri në 15 muaj. Zakonisht, gazetari nuk do ta lëshojë punën. Pronarët nuk kanë asnjë përgjegjësi ligjore ndaj tyre për shkak se nuk kanë kontrata të rregullta të punës. Në këtë mënyrë, gazetarët nuk kërkojnë dot drejtësi, sepse nuk mund ta vërtetojnë se kanë punuar atje."[105]

Situata është e ndryshme me mediat publike, si TV dhe radio, ku gazetarët marrin paga konkurruese dhe gëzojnë edhe sigurim shëndetësor. Pothuajse të gjitha mediat private nuk ofrojnë sigurim shëndetësor për punonjësit. Në Kosovë nuk ka statistika zyrtare mbi pagat në media. Sipas anketës së realizuar me gazetarë dhe redaktorë, pothuajse gjysma gazetarëve deklaruan se pagat e tyre mujore shkojnë nga 200 deri në 500 euro. Ndërsa pagat e redaktorëve shkojnë nga 600 deri në 900 euro.

Tabela 6. Në cilën prej kategorive të mëposhtme bie paga juaj mujore, pas tatimit?

	Totali
0-200 (Euro)	2
200-300	8
300-400	7
400-500	9
500-600	3
600-700	8
700-800	1
800-900	2
900-1000	1
Më shumë se 1000	0
Nuk e di	2
Refuzoj	7
Totali	50

Kohët e fundit, Trupa Ekzekutive e Inspektoratit të Punës (TEIP), e mbështetur nga Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës, ka kryer një inspektim dy-mujor në media për të kontrolluar kontratat e punës dhe sigurinë e shëndetin në punë.[106] Gjatë muajit maj dhe qershor, inspektorët vizituan 34 media në rajonin e Prishtinës, të cilat përfshijnë 1.896 të punësuar. Inspektorët kanë gjetur se 153 punonjës ishin duke punuar për një kohë të gjatë me kontrata të veçanta dhe jo të përhershme, ndërsa 21 të punësuarve u mungonte çfarëdo kontrate.

Për më tepër, në 649 raste organizatat e mediave nuk kanë kompensuar punën jashtë orarit të punonjësve të tyre, ndërrimi i natës nuk është paguar në 83 raste, pushimi i lehonisë nuk është paguar në 1 rast dhe në 26 raste punonjësit që kanë punuar në ditët e festave kombëtare nuk janë kompensuar. Inspektorët gjetën edhe katër raste të lidhura me personat me aftësi të kufizuara, të drejtat e të cilëve nuk janë respektuar. Në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë, inspektorët gjetën se 782 punonjës nuk kishin kaluar kontrolle mjekësore, ndërsa nëntë kompanive u mungonte plani i emergjencës.

Në fund të inspektimit, TEIP-i mendohet të ketë sanksionuar tri organizata mediatike për shkelje të ligjit të punës, pasi ata nuk arritën t'u përgjigjen kërkesave të inspektimeve. Megjithatë, nuk është e qartë se çfarë veprimesh të mëtejshme ka ndërmarrë TEIP-i në lidhje me numrin e shkeljeve që gjenden në mesin e mediave, shumë prejt të cilave shkelin ligjin e punës me të dyja këmbët. Pas inspektimeve, AGK u lidh edhe dy herë me TEIP-in me anë të korrespondencës zyrtare për të kërkuar raportin mbi gjetjet e inspektimit, por kjo kërkesë u refuzua

Në radhë të parë, AGK kërkoi nga inspektori i përgjithshëm t'i sigurohej raporti me të gjitha rastet e shkeljeve në bazë të ligjit për qasje në dokumente publike. AGK e sfidoi, dhe më pas erdhi refuzimi. Inspektorati siguroi disa informacione në fund, por ishin të kufizuara në të dhëna statistikore. Nuk është e qartë pse informacioni i dhënë u kufizua në këtë mënyrë, veçanërisht sepse do të ishte në interes të publikut të dihet rezultati i hetimeve të tyre. Megjithatë, nëse TEIP-i nuk vazhdoi me masa ligjore, çka nuk besohet se e ka bërë, atëherë qasja e tij këtu nuk është dhe aq shumë në shërbim të interesit publik, por për mbrojtjen e identitetit të këtyre punëdhënësve që shkelin ligjin në mënyrë flagrante, por nuk përballen me masa ligjore edhe kur hetohen nga rregullatorët.

Gjatë anketës me gazetarë, 27 të anketuar (23 të anketuar nga 50 nuk kishin të drejtë të përgjigjen në këtë pyetje sepse kanë më pak se pesë vjet përvojë në gazetari) u përgjigjën në pyetjen nëse ka pasur rritje ose ulje të pozitës së tyre ekonomike. Pothuajse gjysma e tyre (13 ose 48%) tha se nuk kishte asnjë ndryshim, që do të thotë se situata është po aq e keqe sa më parë, 9 (33%) u përgjigjën "është zvogëluar disi", ndërsa 3 gazetarë (11%) u përgjigjën "rritur disi". Një gazetar zgjodhi opsionin "rritur shumë", dhe një gazetar tha se ka pasur "shumë rënie".

105 Besnik Boletini, gazetar, intervistuar më 27 prill, 2016
106 Haxhijaj Alberina, "Gjobiten Tri Media", Kallxo, 9 korrik, 2016. Qasur më 28 korrik 2016: http://kallxo.com/gjobiten-tri-media/

Tabela7. Orët mesatare të punës së gazetarëve (majtas) dhe pozita ekonomike e gazetarit.

Orët mesatare të punës së gazetarëve	Totali	Pozita ekonomike e gazetarëve	Totali
Rritur shumë	1	Rritur shumë	1
Rritur disi	9	Rritur disi	3
Nuk ka ndryshuar	9	Nuk ka ndryshuar	13
Ulur disi	5	Ulur disi	9
Ulur shumë	1	Ulur shumë	1
Nuk e di	2	Nuk e di	0
Refuzoj	0	Refuzoj	0
Gjithsej	27	Gjithsej	27

B.2 Cili është niveli i pavarësisë editoriale nga pronarët e mediave dhe strukturat udhëheqëse?

Media më të mëdha kanë struktura të brendshme organizative që i mbajnë redaksitë të ndara nga menaxherët dhe departamentet e marketingut, por pavarësia është ende e diskutueshme, sepse herë pas here menaxherët dhe pronarët përpiqen të ndikojnë në redaksi që të heshten qëndrimet kritike ndaj kompanive që publikojnë reklamat e tyre në mediat e tyre.[107]

> "Mediat në Kosovë mbyllen për shkak të mungesës së financave. Unë kam punuar në disa redaksi dhe ka një ndarje fizike mes redaksive dhe menaxherëve. Por, vështirë të gjeni një medium që ka redaksi të pavarur. Pronarët dhe menaxherët gjithmonë ndërhyjnë."[108]

Redaksitë e lajmeve të mediave më vogla që kanë dy tre gazetarë, nuk kanë redaksi të ndara nga menaxherët dhe departamentet e marketingut. Mediat më të vogla, veçanërisht mediat online, kanë zyra të vogla, me redaksi të përbërë nga dy apo tre gazetarë.

> "Kjo është diçka që vështirë të ndahet. Mediat sot udhëhiqen nga individë që bëjnë pothuajse çdo gjë, dhe këta individë janë në fakt menaxherët. Ka një fuqi të centralizuar të menaxherëve që e ngatërron biznesin me raportimin profesional. Kjo ndarje mund të ndodhë kur ka një qëndrueshmëri financiare të mediave."[109]

Duke qenë një çështje thjesht e brendshme, mund të jetë e vështirë të shqyrtohet. Tendenca tregon se organizatat më të mëdha e me strukturë formale kanë më shumë gjasa të financohen mirë, si dhe mund t'i kenë kontrollet e nevojshme për të ruajtur pavarësinë. Mediat e vogla, duke përfshirë portale online, varen nga të ardhurat e marketingut për të vepruar, e mund ta kenë të vështirë ose të pamundur të krijojnë një strukturë formale, çka e bën shumë më të vështirë të sigurohet pavarësia.

Të pakta janë mediat që kanë miratuar kode të brendshme të etikës. Të tjerët janë në pajtim me kodin e përgjithshëm të etikës të miratuar nga Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, për mediat e shtypura. Transmetuesit privatë janë në pajtim me kodin e përgjithshëm të etikës së Komisionit të Pavarur për Media.

107 Freedom House, Liria e shtypit 2015, Qasur më 10 tetor, 2016: https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/kosovo
108 Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016
109 Betim Musliu, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016

> "Kam punuar në disa media dhe nuk ka pasur rregulla specifike të brendshme; përveç që kishin vetëm kodet që janë të hartuara nga Këshilli. Por nuk ka rregulla të brendshme, përveç që të thonë kur duhet të vish në punë e kur të largohesh. Nuk ka asnjë investim nga mediat dhe kjo duhet të ndodhë."[110]

Mbështetja në Kodin e Etikës së KMSHK-së, si pikënisje mund të jetë një hap i rëndësishëm për krijimin e etikës më të mirë në gazetari. Kjo, nga ana tjetër, mund t'i bindë mediat t'i nënshtrohen modelit vetërregullues sidomos në rastin e mediave online, dhe me kalimin e kohës kjo mund të kontribuojë në përmirësimin e etikës në gazetari. Kjo ndodh pjesërisht sepse përvoja e KMSHK-së mundet me kalimin e kohës të përvetësohet nga organet e mediave, pasi si anëtarë të KMSHK-së ata mund të angazhohen me KMSHK-në dhe ankesat që bëhen në lidhje me Kodin e Etikës. Aktualisht, teksa fokusi mund të jetë në dokumentet e jashtme, me kalimin e kohës angazhimi në këtë proces mund të rezultojnë në përmirësime nga brenda.

Brenda sektorit privat, mungesa e kontratave të punës dhe vonesa e pagave janë arsyet kryesore pse gazetarët në Kosovë ndihen të pasigurt dhe të varur nga pronarët e mediave. Kjo çon në vetë-censurë, e cila është një nga problemet më të mëdha në gazetarinë e Kosovës. Pagesat me vonesë të rrogave janë gjithashtu një formë e trysnisë së tërthortë mbi gazetarët. Vonesat zgjasin me muaj. Ndonjëherë rrogat nuk paguhen në shumën e plotë.

> "Ndërhyrjet, mungesa e kontratave, mungesa e pagesave janë disa nga trysnitë e brendshme ndaj gazetarëve. Ka një sistem në redaksi; thonë u duhet të rendin pas reklamave, sepse nuk ka para. Dhe të thonë nuk mund të shkruash për këtë apo atë kompani. Kjo situatë sjell shumë shpesh një vetë-censurë."[111]

Hulumtimi i këtij projekti tregon dhjetëra portale të lajmeve që nuk shpalosin të dhënat e pronësisë dhe nuk vendosin emrin e gazetarit që ka shkruar artikullin. Gjatë intervistave në thellësi me gazetarët, shumë prej tyre deklaruan se portalet pa pronësi dhe ekipit editorial qëndrojnë pas agjendave politike. "Të gjitha partitë politike kanë portalet e tyre, vetëm që të kenë mundësi ta sulmojnë njëri-tjetrin në publik. Ndoshta ato (portale), nuk njihen në këtë mënyrë nga publiku, por rrethi i gazetarëve e di se pothuajse çdo parti politike ka një portal."[112]

Disa gazetarë pretendojnë se portale të tilla keqpërdorin lirinë e shprehjes dhe shkelin kodin e etikës, andaj personat që sulmohen nga artikujt e tyre nuk kanë asnjë shans për të reaguar apo për t'u ankuar. "Ka dhjetëra portaleve që nuk kanë as email as kontakte. Nëse më sulmojnë, për shembull, ku duhet ta adresoj shqetësimin tim? Duke pasur këtë parasysh, se nuk ke mundësi t'i kontaktosh, kjo do të thotë se ato (portalet) kanë një qëllim të caktuar dhe nuk i japin përgjigje askujt."[113]

Opinionet janë të ndara në lidhje me shfaqjen së fundmi të portaleve në mediat e Kosovës. Disa gazetarë mendojnë se portalet duhet të ketë trupin e tyre vetë-rregullues që do të jetë në një pozitë më të mirë për të mbikëqyrur punën e përgjithshme të portaleve. "Portalet duhet të kenë shtëpinë e tyre. E ardhmja është drejt portaleve, interneti sot është çdo gjë, ka web TV kudo në portale. Rregullimi i portaleve të tilla duhet të bëhet në mënyrë të veçantë, përmes një shoqatë e pavarur."[114]

110 Po aty, 96
111 Besnik Boletini, gazetar i OJQ "Çohu", intervistë mbajtur më 27 prill, 2016
112 Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 3 maj, 2016

113 Besnik Boletini, gazetar, intervistuar më 27 prill, 2016
114 Betim Musliu, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016

B.3 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në RTK?

RTK ka kodin e vet të sjelljes të quajtur "Standardet profesionale dhe parimet etike në programet e RTK-së".[115] Megjithatë, shumica e gazetarëve të intervistuar pohojnë se kodi zbatohet dobët në praktikë nga gazetarët e RTK-së, dhe kjo është për shkak të ndërhyrjes aktive politike, direkt në politikën editoriale. Një gazetar komentoi: "I kam studiuar rregullat e brendshme të RTK-së dhe kodin e sjelljes dhe konsideroj se përmban standarde të avancuara. Për fat të keq, nuk zbatohen nga gazetarët dhe arsyeja është e thjeshtë. Është ndikimi i politikës në transmetuesin publik.[116] Një gazetar tjetër tha: "RTK nuk ka pavarësi. Ka redaktorë që janë shërbëtorë të politikanëve. Ka pasur një rast kur një redaktor dërgoi një SMS ku pyeste: "Shef a ju pëlqeu storja".[117]

Pavarësisht standardeve të brendshme, menaxhmenti i Radio Televizionit të Kosovës (RTK) është kritikuar publikisht shumë herë për ndërhyrje në punën e redaktorëve.

> "Pasi që ka shumë kritika publike ndaj disa individëve brenda RTK-së që ndërhyjnë në politikën editoriale dhe në punën e gazetarëve, kjo tregon se aty diçka shkon vërtet keq. Kjo ndikon në punën e gazetarëve, mbi atë që duhet të raportojnë apo jo. Ka shumë probleme që u shfaqën në publik, por nuk janë adresuar sa duhet."[118]

Në prill 2015, 60 gazetarë dhe redaktorë shkruan një letër publike duke kritikuar menaxhmentin dhe drejtorin gjeneral për ndërhyrje, censurë dhe keqmenaxhim. Letra, ndër të tjera, pohonte se gazetarët dhe redaktorët janë të detyruar të përfshijnë zyrtarët e qeverisë në mbulimin e lajmeve duke censuruar përfshirjen e aktivistëve të shoqërisë civile.[119]

> "Nuk janë respektuar rregullat për t'i mbajtur redaksitë të pavarur nga menaxhmenti. Faktorët e jashtëm kanë ndikuar. Është politika që ndikon menaxhmentin. Në përgjithësi, ka presione të drejtpërdrejta politike që po ushtrohen në drejtim të menaxhmentit dhe redaktorëve."[120]

Në kuadër të transmetuesit publik, çështja e financave është një çështje kyçe shqetësuese, sepse Qeveria e përdor si levë për të ndikuar në politikën e redaksisë së lajmeve. Analiza e raportimit të transmetuesit publik në baza ditore, tregon qartë se ata e kuptojnë disi ndryshe nga mediat e tjera shërbimin e interesit publik përmes shqyrtimit të politikave dhe iniciativave qeveritare. Është me rëndësi të thuhet se në momente të caktuara transmetuesi publik rrezikon të tingëllojë si zëdhënës zyrtar i qeverisë, duke plotësuar mungesën e raportimit mbi takimet dhe vizitat zyrtare që kanë ndodhur, pa dhënë ndonjë përmbajtje substanciale lidhur me lëndën e takimeve të tilla ose shqyrtimin e politikave qeveritare.

115 I qasshëm në http://www.rtklive.com/new/en/etc/RTK_Professional_Standards.pdf
116 Betim Musliu, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016
117 Taulant Qenaj, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016
118 Kreshnik Gashi, gazetar, intervistë mbajtur më 4 maj, 2016
119 Koha Ditore, "60 redaktorë e gazetarë të RTK-së reagojnë ndaj letrës së Shalës drejtuar Reporterëve pa Kufij." Koha Ditore, 12 prill, 2015. Qasur më 30 korrik 2016: http://koha.net/?id=&l=52614
120 Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016

B.4 Cili është niveli i pavarësisë editoriale të gazetarëve në sektorin jo-fitimprurës?

Mediat jo-fitimprurëse janë në përputhje me kodin e përgjithshëm të etikës për media të shkruar dhe vizive. Disa kanë kode të brendshme të sjelljes.

Një numër i organizatave të mediave jo-fitimprurëse në Kosovë financohen nga organizatat ndërkombëtare të mediave, qeveri të huaja, ambasada, Komisionin Evropian dhe institucione të tjera të BE-së. Ka disa organizata jo-fitimprurëse, si Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), Çohu dhe Instituti i Kosovës për Drejtësi që janë të përqendruar në gazetarinë investigative. Këto media mbulojnë çështje të tilla si sistemi i drejtësisë, shpenzimet publike dhe korrupsioni.

Sektori jo-fitimprurës i mediave qëndron më mirë në lidhje me financat, duke pasur parasysh se funksionon bazuar vetëm në donacione. Ky sektor ofron trajnime për gazetarët që synojnë standarde më të larta profesionale. "Sektori jo-fitimprurës nuk siguron raportim të paanshëm dhe profesional. Mendoj se ambasadat mund të kenë ndikim mbi ta (sektori jo-fitimprurës)."[121] Një tjetër gazetar i intervistuar theksoi: "Ka pasur kritika më parë, nuk e di a vazhdon ende, por ka pasur një pyetje të ngritur pak kohë më parë, nëse politika editoriale në sektorin jo-fitimprurës është prekur nga donatorët."[122]

Në tërësi, sektori jo-fitimprurës, për shkak të çështjeve që trajton, mund të përballet me më shumë sfida, duke përfshirë kundërgoditje në lidhje me çështjet që trajton. Sektori jo-fitimprurës është përlyer me akuzat për financime dhe burime të dyshimta. Drejtoresha e BIRN-it Jeta Xharra u përball me një fushatë shpifjesh me disa artikuj nga gazeta e përditshme "Infopress". Kërcënimet publike ndaj Xharrës erdhën pasi ekipi i saj shfaqi një program televiziv mbi keqadministrimin e pretenduar në komunën e Skënderajt, ku Sami Lushtaku është kryetar. Në qershor të vitit 2013, gjykata në Prishtinë i liroi pesë të pandehurit të akuzuar për organizimin e një fushate urrejtjeje në media kundër Xharrës.[123] Të akuzuarit ish-in Sami Lushtaku, kryetari i komunës së Skënderajt, Rexhep Hoti, ish-pronari i Infopress, ish kryeredaktori Avni Azemi, dhe dy ish-gazetarë, Rizah Hajdari dhe Qani Mehmedi. Infopress botoi 12 artikuj duke e quajtur Xharrën "spiune serbe", "bombë profesionale" dhe një "prostitutë e ambasadës", mes fyerjesh të tjera.

Edhe disa organizata janë sulmuar. Natën e 11 qershorit 2015, portali serb "Kossev", që ndodhet në pjesën veriore të Mitrovicës, u sulmua me armë të lehta nga persona të panjohur.[124] U goditën dritaret dhe muret e jashtme të ndërtesës. Policia e Kosovës gjeti nëntë gëzhoja pranë zyrës. Nuk ka lëndime njerëzore të raportuara. Motivi i sulmit është i panjohur.

B.5 Sa liri kanë gazetarët në procesin e prodhimit të lajmeve?

Gazetarët në Kosovë janë relativisht të lirë t'i zgjedhin lajmet në baza ditore. Megjithatë, gazetarët e intervistuar deklaruan se i takon politikës editoriale të mediave të vendosin për zgjedhjen e lajmeve të përditshme që raportohen si dhe këndin që duhet theksuar. Gazetarët gjithashtu shohin nevojën e zhvillimit një lloj logjike kur bëhet fjalë për lajmin e sugjeruar. Në fakt, kjo bën që ata ta dinë ç'lloj lajmi mund të propozojnë si ide, bazuar në atë që pronarët duan të shohin dhe dëgjojnë.

> "Besoj se ka hezitim mes një numri të madh të gazetarëve të merren me tema të caktuara. Duket se ata i kanë përqafuar plotësisht politikat editoriale. Nuk është se ata nuk janë gazetarë të mirë, por duket se kanë bërë paqe me idenë se nuk mund të punojnë për tema të mëdha, sepse nuk kanë hapësirë ku t'i transmetojnë."[125]

Gjatë anketës, gazetarët u pyetën për shumë faktorë që mund të ndikojnë në punën e tyre të përditshme. Ata deklaruan se redaktorët kanë më shumë ndikim (tepër, shumë apo deri diku me ndikim - 84%) në punën e tyre, ndërsa menaxherët (44%) dhe pronarët (42%) kanë më pak ndikim. Në anën tjetër, politikanët në përgjithësi (14%) dhe zyrtarët e qeverisë (14%) kanë shumë më pak ndikim në punën e përditshme të gazetarëve, e në fund individët që punojnë në mjedisin e tyre të përditshme.

Mbi censurën, gazetarët (30%) u shprehen se është ka disi ndikim në punën e tyre, ndërsa 28 për qind e gazetarëve thanë se censura nuk ka ndikim.

121 Taulant Qenaj, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016
122 Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më 26 prill, 2016
123 Edona Peci "Gjykata gjen të pafajshëm të pandehurit në rastin e BIRN në Kosovë". Balkan Insight, 5 qershor 2013. Qasur më 2 gusht, 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/defendants-in-birn-vs-infopress-case-acquitted

124 Kosova Press, "Persona të armatosura sulmojnë selinë e portalit Kossev në veri të Kosovës". Kosova Press, 11 qershor, 2015. Qasur më 2 gusht, 2016: http://www.kosovapress.com/en/security/sulmohet-me-arme-selia-e-portalit-kossev-ne-veri-44410/
125 Kreshnik Gashi, gazetar, intervistë mbajtur më 4 majth, 2016

Tabela8. Sa ndikon secila kategori në punën tuaj?

	Tepër ndikues (%)	Shumë ndikues (%)	Disi ndikues (%)	Pak ndikues (%)	Jo ndikues (%)	Jo relevant për punën e të anketuarit (%)	Nuk e di (%)	Refuzoj (%)
Vlerat dhe besimet tuaja personale	11	9	18	4	5	3	0	0
Kolegët tuaj në staf	2	8	26	9	5	0	0	0
Mbikëqyrësit tuaj editorialë dhe redaktorët më të lartë	14	20	50	14	2	0	0	0
Menaxherët e organizatës suaj të lajmeve	8	6	30	36	16	2	2	0
Pronarët e organizatës suaj të lajmeve	8	14	20	24	26	6	2	0
Politika redaktoriale	6	21	15	5	3	0	0	0
Marketingu	1	2	9	16	16	4	2	0
Pritshmëritë e fitimeve	1	1	5	11	28	3	1	0
Hulumtimi dhe të dhënat e publikut	12	23	8	6	0	1	0	0
Disponueshmëria e burimeve për mbledhjen e lajmeve	15	17	13	2	2	1	0	0
Afatet kohore	19	19	12	0	0	0	0	0
Etika e gazetarisë	39	9	1	0	1	0	0	0
Konsiderata fetare	3	2	9	5	23	7	1	0
Ligji i shpifjes	16	6	14	4	7	0	2	1
Miqtë, të njohurit dhe familja juaj	3	4	17	13	13	13	0	0
Kolegë në media të tjera	2	1	26	10	11		0	0
Reagime nga publiku	6	20	18	4	2		0	0
Organizatat konkurente të lajmeve	6	11	19	8	6		0	0
Ligji dhe rregulloret e mediave	14	25	7	2	1		1	0
Qasja në informacion	22	21	7	0	0		0	0
Censura	10	18	30	12	28		2	0
Zyrtarët qeveritare	0	4	10	24	62		0	0
Politikanët	2	4	8	16	70		0	0
Grupet e trysnisë								
Afaristët	0	4	6	24	66		0	0
Marrëdhëniet me publikun	2	16	23	4	5		0	0
Ushtria, policia dhe sigurimi i shtetit	2	9	9	9	20		1	0

C

Siguria gazetarëve

C.1 Siguria dhe statistikat e pandëshkueshmërisë

Ka raste sporadike të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve në Kosovë. Në vitin 2016, AGK ka regjistruar 12 raste të kërcënimeve dhe sulmeve, ndërsa në vitin 2015 asociacioni ka regjistruar 15 raste, duke përfshirë kërcënimet, sulmet fizike, frikësimet dhe dëmtim të pronës.

Tabela 9. Statistikat e kërcënimeve dhe sulmeve ndaj gazetarëve

Vite	Kërcënime	Sulme fizike	Frikësim	Dëmtim i pronës	Sulme me bomba/ armë	Totali
2014	5	11				16
2015	5	1	7	1	1	15
2016 (deri në 24 tetor)	6	1	2	1	2	12
						43

Nga viti 2013 deri në gusht të vitit 2016, Policia e Kosovës ka regjistruar 62 raste të raportuara nga gazetarët e Kosovës. 18 raste janë ende nën hetim policor, ndërkohë që policia e ka dorëzuar pjesën tjetër në prokurorinë e Prishtinës. Shumica e rasteve lidhen me kërcënime, disa raste janë të lidhura me sulme fizike dhe dëmtim dhe/ose vjedhje të pasurisë së gazetarëve. Katër raste janë raportuar vetëm në vitin 2016.

Gjatë vitit 2013, sipas statistikave të policisë, 14 raste janë raportuar nga gazetarët, nga të cilat 10 janë të lidhura me kërcënime. Tre gazetarë u sulmuan fizikisht. Në 1 maj, 2013, herët në mëngjes, u sulmua shtëpia e Mufail Limanit, kryeredaktor i RTK-së.[126] Policia raportoi se një bombol gazi u përdor për sulmin dhe shpërthimi shkaktoi vetëm dëme materiale. Policia e quajtur veprën si "shkaktim i rrezikut të përgjithshëm" dhe arsyet e sulmit mbeten të panjohura.

Tabela 9. Statistikat e policisë për sulmet ndaj gazetarëve

Rastet e raportuara në polici	2013	2014	2015	2016 (deri në gusht)	Totali
Kërcënime	10	11	10	2	33
Kërcënime verbale					
Sulme fizike	3	6	2	1	12
Vjedhje dhe dëmtim prone			12	1	13
Frikësim					
Vrasje në tentativë		1			1
Eksploziv, granata sulmuese	1			2	3
					62

Gjatë vitit 2014, 18 gazetarë kanë raportuar raste në policinë e Kosovës. Vetëm katër raste vazhdojnë të jenë nën hetim policor, ndërsa pjesa tjetër janë dërguar në prokurori. Shumica e tyre përfshijnë kërcënime. Rasti më i rëndë është konsideruar të jetë rasti i vrasjes në tentativë ndaj Milot Hasimja, gazetar i televizionit Klan Kosova, i cili u sulmua nga një anëtar i publikut me një thikë në vendin e tij të punës, si kundërpërgjigje ndaj një storie që raportonte mbi sulmuesin.[127]

Një tjetër incident është raportuar më 2 korrik, 2014 nga Mefail Bajqinovci, gazetar i transmetuesit privat KTV, i cili raportoi në polici se kishte marrë një kërcënim telefonik nga një person anonim.[128] Bajqinovci drejton një program televiziv që merret kryesisht me çështjet e korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ai filloi të marrë kërcënime pasi programi i tij diskutoi vrasje të profilit të lartë në Kosovë. Hetimet e policisë zbuluan se thirrja ishte bërë nga burgu i Dubravës.

Një numër i kërcënimeve me anë të Facebook-ut janë bërë gjatë vitit 2014, në veçanti ndaj gazetarëve që raportuan mbi radikalizmin dhe ekstremizmin islamik në Kosovë. Visar Duriqi, gazetar i portalit Gazeta Express, Artan Haraqija, gazetar i pavarur, dhe Arbana Xharra, kryeredaktore e të përditshmes Zëri, kanë raportuar kërcënime me vdekje nëpërmjet Facebook-ut. Visar Duriqi raportoi në polici një kërcënim me vdekje që mori më 15 gusht 2014 nëpërmjet llogarisë së tij në Facebook.

Një sulm tjetër u raportua në 22 qershor 2014, kur tre gazetarë u sulmuan nga persona të panjohur gjatë një proteste në Mitrovicë që kundërshtonte heqjen e barrikadës mbi urën kryesore të qytetit që ndan dy vijat etnike. Pati përleshje ndërmjet protestuesve dhe policisë. Gazetarët Behar Mustafa nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN), Faton Ismaili nga portali Gazeta Express dhe Kajtaz Gecaj nga e përditshmja Zëri, u sulmuan nga protestuesit. Mustafa pësoi lëndime të lehta.[129]

Gjatë vitit 2015, sipas të dhënave të policisë së Kosovës, ka 24 raste të raportuara nga gazetarët. Nga këto raste, tetë janë dërguar në prokurori për hetime të mëtejshme. Gazetarët kanë raportuan raste të kërcënimeve dhe sulmeve fizike. Idriz Morina, kryeredaktor i gazetës ditore "Bota Sot", supozohet të ketë marrë kërcënime me vdekje nga Nuredin Lushtaku, deputet dhe ish-komandant i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), në lidhje me komentet e Morinës mbi përfshirjen e Lushtakut në UÇK.

Më tej, më 11 qershor 2015, dy foto-gazetarë, Blerim Uka i portalit Indeks Online dhe Driton Paqarada i të përditshmes Koha Ditore, thuhet se janë keqtrajtuar nga një polic gjatë një ngjarjeje në stadiumin e Mitrovicës. Rasti është ende nën hetim policor. Gjatë këtij viti, dhjetë gazetarët kanë raportuan në polici dëmtimin dhe vjedhjen e pronës së tyre.

126 EBU, "EBU dënon sulmin ndaj redaktorit të Transmetuesit Publik të Kosovës", 3 maj, 2013. Qasur më 23 tetor 2016: https://www.ebu.ch/contents/news/2013/04/ebu-condemns-attack-on-editor-of.html

127 Roy Greenslade, "Gazetari i TV në Kosovë goditet me thikë nga person i zemëruar nga raporti televiziv", The Guardian, 29 tetor, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: https://www.theguardian.com/media/greenslade/2014/oct/29/journalist-safety-kosovo

128 Njomza Salihi, "Kërcënohet Gazetari Mefail Bajqinovci", 2 korrik, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/gjnk/kercenohet-gazetari-mefail-bajqinovci-1/

129 Telegrafi, "AGK dënon dhunën ndaj gazetarëve në Mitrovicë", 22 qershor, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://telegrafi.com/agk-denon-dhunen-ndaj-gazetareve-ne-mitrovice/

Idriz Morina, kryeredaktor i gazetës ditore Bota Sot është kërcënuar disa herë gjatë karrierës së tij, së fundmi në vitin 2015, kur u kërcënua nga një deputet. AGK e dënuar kërcënimin ndaj Morinës[130], edhe pse Morina ka thënë se prokuroria nuk e ka ftuar kurrë në intervistë dhe asnjë nga rastet e tij nuk ka shkuar në gjykim. "Në një rast kërcënimi, u arrestua një person, por rasti nuk u procedua në gjykatë."[131]

Ka edhe raste historike gazetarësh që nuk janë zgjidhur, që kanë të bëjnë me tre rastet e gazetarëve të vrarë në Kosovë pas luftës që përfundoi në vitin 1999, të cilat mbeten të pazgjidhura. Rasti i fundit i vrasjes së një gazetari ka ndodhur në vitin 2005. Të gjitha rastet raportohet të jenë të motivuara politikisht dhe asnjë prej autorëve nuk është përballur me drejtësinë deri tani.

Në rastet historike, Kosova ka parë edhe vrasjet e gazetarëve. Shefki Popova, gazetar i gazetës së ish-gazetës së përditshme "Rilindja", u qëllua për vdekje më 10 shtator 2000, pranë shtëpisë së tij në Vushtrri.[132] Motivi i vrasjes mbetet i panjohur. Dy persona të paidentifikuar u panë duke ikur pas të shtënave. Në kohën e vdekjes së tij, Popova kishte kandiduar në zgjedhjet komunale, si kandidat i Partisë Social Demokratike të Kosovës.

Fataliteti tjetër ndodhi në 19 tetor 2001, kur Bekim Kastrati, gazetar i së përditshmes Bota Sot, u vra në një pritë në hyrje të Skenderaj. Ai ishte duke vozitur së bashku me tre persona të tjerë. E përditshmja Bota Sot konsiderohet gjerësisht si afërt me LDK-në.[133]

Ndërsa në 3 qershor 2005, u qëllua për vdekje Bardhyl Ajeti, edhe ai gazetar i Bota Sot,.[134] Ajeti u qëllua në kokë në distancë të afërt nga një makinë në kalim, ndërsa ai ishte në makinën e tij me defekt që tërhiqej nga dikush tjetër. Ajeti shkruante editoriale të përditshme dhe shpesh kritikonte figurat e opozitës.

Shumë nga këto raste, qofshin ato historike apo sulme të fundit, mbeten të pazgjidhura. Në dritën e detyrës së rëndësishme që kanë gazetarët për dhënien e informacionit mbi çështje me rëndësi publike, hetimi i këtyre rasteve është tepër i rëndësishëm. Kjo është gjithashtu e rëndësishme, sepse rëndom sulmet që ndodhin janë në një farë mënyre të lidhura me raportimin e gazetarëve. Me fjalë të tjera, lëndimet ose humbja e jetëve të tyre kanë ndodhur teksa ishin në shërbim të interesit publik. Andaj, është e rëndësishme të dërgohet një mesazh i fortë nga sistemi i drejtësisë, se sulme të tilla nuk do të tolerohen, pa marrë parasysh kush i nxit, dhe hetimet e proceset do të kryhen në kohën e duhur.

130 *Telegrafi, "AGK dënon kërcënimin ndaj kryeredaktorit të "Botës Sot". 1 gusht, 2015. (AGK dënon kërcënimin ndaj kryeredaktorit të "Botës Sot"). Qasur më 26 tetor, 2016: http://telegrafi.com/agk-denon-kercenimin-ndaj-kryeredaktorit-te-botes-sot/*

131 *Idriz Morina, kryeredaktor i gazetës së përditshme "Bota Sot", iu përgjigj autorit më 27 shtator 2016*

132 *I qasshëm në: https://cpj.org/killed/2000/shefki-popova.php*

133 *I qasshëm në: https://www.cpj.org/killed/2001/bekim-kastrati.php*

134 *I qasshëm në: https://www.cpj.org/killed/2005/bardhyl-ajeti.php*

C.2 A mbajnë përgjegjësi institucionet shtetërore dhe aktorët politikë për mbrojtjen e gazetarëve?

Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2015-2018 ka një kapitull që fokusohet në garancitë që duhet të sigurohen për lirinë e fjalës dhe standardet profesionale. Qeveria u angazhua në këtë dokument, që çështje si "autonomia e gazetarëve dhe botuesve, mbrojtja e standardeve profesionale të gazetarisë, e drejta për t'u përgjigjur dhe korrigjim për publikun, duhet të rregullohet nga legjislacioni përkatës në bazë të standardeve demokratike ndërkombëtare."[135] Qeveria dhe parlamenti i dënojnë shumë rrallë sulmet kundër gazetarëve. Megjithatë, të dy mund të marrin një rol më aktiv me Komisionet përkatëse të Kuvendit, të cilët kanë një rol kyç në mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit dhe ngritjen e çështjeve me rëndësi publike, duke përfshirë shqyrtimin ose jo të vendimeve të qeverisë.

Nuk ka mekanizëm të veçantë të qeverisë për monitorimin dhe raportimin mbi kërcënimet, ngacmimet dhe dhunën ndaj gazetarëve. Policia e Kosovës mban shënime të sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve, për sa kohë që rastet i raportohen këtij institucioni. Në të njëjtën kohë, institucioni i Avokatit të Popullit mund të ketë një rol të rëndësishëm për të luajtur kur ka mosveprim nga institucionet në hetimin ose procedimin me mënyrën e duhur. Institucione të tjera mund të kenë një rol për të luajtur, si Inspektorati i Punës ose Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Shumë nga këto institucione duhet të punojnë së bashku në mënyrë që të bashkërendojnë proceset e tyre dhe të sigurohen se gazetarëve u jepet mbrojtje efektive.

135 *http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government_Programme_2015-2018_eng_10_mars.pdf*

C.3 A i trajton me efektivitet sistemi i drejtësisë penale dhe civile kërcënimet dhe aktet e dhunës kundër gazetarëve?

As prokuroria dhe as gjykatat në Kosovë nuk i regjistrojnë ndaras rastet penale që janë kundër gazetarëve. Gjithashtu, nuk ka procedura të veçanta që mund të trajtojnë në mënyrë të përshtatshme sulmet ndaj gazetarëve, veçanërisht femrave gazetare. "Absolutisht nuk ka efektivitet të sistemit të drejtësisë për dhunën ndaj gazetarëve. Ka shumë shembuj, kur rastet janë të qarta, me dëshmi dhe kryesit janë të njohur, por drejtësia është kaq e ngadalshme për t'u marrë me raste të tilla."[136]

Ka dy raste kur masat e mbrojtjes janë dhënë për dy gazetarë nga ana e policisë së Kosovës. Më 3 shtator 2014, Reporterët pa Kufij shprehën shqetësimet për sigurinë e një gazetari në Kosovë, i cili ishte kërcënuar nga radikalët myslimanë, dhe kërkonin nga autoritetet t'i ofronin mbrojtje gazetarit.[137] Dy ditë më pas, policia e Kosovës ofroi mbrojtje për gazetarin. Rasti i dytë përfshinte një gazetar investigativ, i cili publikoi përgjime të rrjedhura që përfshinin një deputet të Kosovës. Në gusht të vitit 2016, Policia e Kosovës i ofroi mbrojtje të afërt gazetarit, pasi ai i informoi se ai personalisht dhe stafi i lajmeve ishin nën mbikëqyrje nga njerëz të panjohur. Gazetari refuzoi mbrojtjen e afërt.[138]

Gazetarët e intervistuar thanë se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk është efektiv kur gazetarët kërcënohen apo frikësohen. Një nga rastet e përmendura ishte ai i kërcënimit ndaj të birit të kryeministrit Isa Mustafa. Rasti ka ndodhur në vitin 2015, personi që kërcënonte djalin e kryeministrit nëpërmjet Facebook-ut u arrestua, u ngrit aktakuya dhe e dënua brenda tri ditëve. "Kur një deputet nga partia opozitare, merr një kërcënim me anë të Facebook-ut, një rast më i rëndë se ai i djalit të Kryeministrit, atëherë policia dhe prokuroria bien në gjumë. Kjo është drejtësi selektive".[139]

Një numër i rasteve janë trajtuar nga gjykata në vitet e fundit. Gjatë zgjedhjeve komunale në vitin 2013, u sulmuan një gazetar dhe kameraman i kanalit në gjuhën serbe RTV Puls. Marko Stankoviç, kameramani, u rrah nga një grup njerëzish, pasi ekipi shkoi për të filmuar një incident të raportuar në një qendër votimi në fshatin Partesh. Stankoviçit ia shkatërruan edhe kamerën. Gjykata Themelore në Gjilan ka dënuar katër persona

136 *Gazetar anonim, intervistë e mbajtur më*
137 *I qasshëm në: https://rsf.org/en/news/authorities-urged-protect-kosovar-reporter-threatened-muslim-radicals*
138 *I qasshëm në:https://www.youtube.com/watch?v=vbclw_8RYZw*
139 *Betim Musliu, gazetar, intervistuar më 29 prill, 2016*

të përfshirë në këtë rast. Secili prej tyre u dënua me tre muaj burg dhe 200 euro gjobë.[140]

Në të njëjtin vit, Adem Lushaj, korrespondent i gazetës së përditshme Bota Sot, raportoi në polici një kërcënim që mori nga një zyrtar lokal komunal.[141] Lushaj tha se ishte kërcënuar me thirrje telefonike nga një zyrtar komunal. Zyrtari nuk ishte i kënaqur me artikullin e Lushajt. Artikulli bazohej në deklaratën për shtyp një dege lokale të opozitës që kritikonte partinë në pushtet, në të cilën përmendej edhe emri i zyrtarit. Në 15 janar 2014, gjykata e vendit vendosi se zyrtari ishte fajtor dhe vendosi ta gjobisë me 500 euro. Gjykata e pezulloi gjobën, domethënë zyrtari nuk do të duhet ta paguajë nëse nuk kryen një vepër tjetër brenda një viti.

Gjatë vitit 2014, Milot Hasimja, gazetar i televizionit privat Klan Kosova ishte në detyrë në kohën e sulmit.[142] Ai u godit me thikë në kokë dhe në qafë nga një i ri. Autori ishte pjesë e një raporti nga gazetari, dhe me sa duket nuk i kishte pëlqyer. Në 5 nëntor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë dënoi autorin e krimit me katër vjet burg dhe 1.000 euro gjobë.

Ndërsa gjatë vitit 2015, gjykata lokale në Gjakovë dha një dënim te pezulluar me një vit burg ndaj autorit të kërcënimit. Shkelësi nuk do të shkojë në burg nëse nuk kryen një tjetër vepër penale gjatë një periudhe dy vjeçare. Gjykata vendosi të konfiskojë një telefon celular dhe një aparat fotografik që u përdorën për veprën.[143]

Me sa duket, policia, prokuroria dhe gjykatat kanë rol kyç për t'u siguruar që çështjet të trajtohen në kohën e duhur. Rastet tregojnë se në tërësi sistemi i drejtësisë u është përgjigjur çështjeve me të cilat përballet çdo gazetar. Megjithatë, në lidhje me rastet e dhunës ndaj gazetarëve, duhet të pranohet se koha është esenciale, pasi drejtësia e vonuar mund të jetë drejtësi e mohuar. Mbi këtë bazë, duhet të konsiderohen mekanizmat e filtrimit brenda policisë, prokurorisë dhe gjykatave, në mënyrë që raste të tilla të trajtohen së bashku me viktimat e tjera të rrezikuara, për t'u siguruar së qasja në drejtësi nuk pengohet, si dhe për t'u dekurajuar kushdo që sulmon gazetarët në detyrë, pavarësisht nga pasuria e tyre apo pozita në shoqëri.

---

140 Tefik Dushica, administratori i zyrës së prokurorisë së Gjilanit, email për autorin më 15 prill 2016

141 Armend Zenelaj, "Drejtori i Arsimit në Deçan dënohet për kërcënimin e një gazetari", Kallxo.com. 15 janar, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/gjnk/drejtori-i-arsimit-ne-decan-denohet-per-kercenim-ndaj-gazetarit-tv/

142 Fillorete Konjuhi, "Sovran Syla u dënua me 4 vjet burg për sulmin ndaj gazetarit Milot Hasimja", Klan Kosova, 5 nëntor 2015. Qasur më 23 tetor 2016: http://klankosova.tv/sovran-syla-u-denua-me-4-vjet-burgim-per-sulmin-ndaj-gazetarit-milot-hasimja-video/

143 isar Duriqi, viktima, email për autorin, 5 gusht, 2016

Shtojca

Lista e personave të intervistuar

Emri	Pozita/Organizata	Data e intervistës
Liridon Llapashtica	Ish-gazetar	25 prill 2016
(Anonim)	Gazetar në gazetë	26 prill 2016
Flutura Kusari	Eksperti i ligjit të mediave	26 prill 2016
Parim Olluri	Gazetar në Insajderi.com	27 prill 2016
Besnik Boletini	Gazetar në preportr.com	27 prill 2016
Taulant Qenaj	Gazetar në televizion privat	29 prill 2016
Betim Musliu	OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi	29 prill 2016
Artan Haraqija	Gazetar i pavarur	3 maj 2016
(Anonim)	Gazetar në gazetë	4 maj 2016
Kreshnik Gashi	Gazetar në BIRN	4 Maj 2016
Furtuna Sheremeti	Ekspert ligjor	5 maj 2016
Fatos Shala	Gazetar në gazetaexpress.com	5 maj 2016
(Anonim)	Gazetar në një stacion televiziv	10 maj 2016
Zenun Pajaziti	Anëtar i Kuvendit	26 maj 2016

Referenca dhe burime

Bibliografi

Libra, kapituj, artikuj:

GAP, Qasja në Dokumente Publike, Seria e Hulumtimeve Parlamentare, Prishtinë: 2010. Qasur më 10 tetor 2016: http://www.institutigap.org/documents/65564_AccessDocuments.pdf

"EBU dënon sulmin ndaj redaktorit të Transmetuesit Publik të Kosovës". 3 maj 2013. Qasur më 23 tetor 2016: https://www.ebu.ch/contents/news/2013/04/ebu-condemns-attack-on-editor-of.html

"Liria e Mediave dhe Siguria e Gazetarëve në Kosovë", OSBE, Prishtinë: 2009. Qasur më 10 tetor 2016: https://www.osce.org/kosovo/122390?download=true

"Liria e shtypit 2015", Freedom House. Qasur më 10 tetor 2016: https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/kosovo

Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) http://www.arbk.org/en/Home

"Statuti i Këshillit të Mediave të Shtypura të Kosovës", Këshilli i Mediave, modifikuar për herë të fundit më 23 tetor, 2016. http://presscouncil-ks.org/wp-content/uploads/2015/04/Statute_PCK_English.pdf

"Raporti i Progresit të Kosovës 2015", Komisioni Evropian, Bruksel: 2016. Qasur më 10 tetor 2016: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

"Raporti i Progresit të Kosovës 2015", Komisioni Evropian, Bruksel: 2016. Qasur më 10 tetor 2016: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

"Raporti për Qasje në Dokumente Publike 2013-2014", BIRN. Prishtinë, 2013 Qasur më 6 gusht 2016: http://www.drejtesianekosove.com/repository/docs/report_on_access_to_public_documents_2013-2014_824655.pdf

"Standardet Profesionale dhe Parimet e Etikës Gazetareske në programet e RTK-së". Modifikuar për herë të fundit në 2 tetor, 2016 http://www.rtklive.com/new/en/etc/RTK_Professional_Standards.pdf

BBC, Iniciativa për zhvillimin e mediave afrikane, në dispozicion në: http://downloads.bbc.co.uk/worldservice/trust/pdf/AMDI/AMDI_summary_Report.pdf

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Shih më shumë: https://www.cpj.org /

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Bardhyl Ajeti, 2005. Mund të gjendet në: https://www.cpj.org/killed/2005/bardhyl-ajeti.php

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Bekim Kastrati, 2001. Mund të gjendet në: https://www.cpj.org/killed/2001/bekim-kastrati.php

Komiteti për Mbrojtjen e Gazetarëve, Shefki Popova, 2000. Mund të gjendet në: https://cpj.org/killed/2000/shefki-popova.php

Këshilli i Evropës, Treguesit e mediave në një demokraci, Strasburg 2008, mund të gjendet në: http://assembly.coe.int/nw/xml/XRef/Xref-XML2HTML-en.asp?fileid=17684&lang=en

Freedom House, Metodologji e Lirisë së Shtypit 2015, gjendet në: https://freedomhouse.org/report/freedom-press-2015/methodology

Freedom House, Liria e Shtypit 2015. Qasur më 11 tetor 2016: https://freedomhouse.org/report/freedom-press/2015/kosovo

INDEP, Gjendja e Mediave në Kosovë 2015. Qasur më 11 tetor 2016: http://indep.info/en/publications/

IREX, Indeksi i Qëndrueshmërisë së Medias 2016. Qasur më 11 tetor 2016: https://www.irex.org/sites/default/files/pdf/media-sustainability-index-europe-eurasia-2016-kosovo.pdf.pdf

IREX, Metodologjia e indeksit të qëndrueshmërisë së mediave, në dispozicion në: https://www.irex.org/resource/media-sustainability-index-msi-methodology

Ministria e Financave, raportin vjetor financiar. Prishtinë, 2016 http://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/3BAC8FEA-4544-4169-94BA-0D619CF6745C.pdf

Autoriteti rregullator i komunikimeve elektronike dhe postare, në dispozicion në: http://www.arkep-rks.org/?cid=2,1

Reporterët pa Kufij, "Thirrje autoriteteve për të mbrojtur gazetarin kosovar të kërcënuar nga radikalët myslimanë". Mund të gjendet në: https://rsf.org/en/news/authorities-urged-protect-kosovar-reporter-threatened-muslim-radicals

Reporterët pa Kufij, në dispozicion në: https://rsf.org/index2014/en-index2014.php

Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Raporti gjithëpërfshirës i institucioneve publike për realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, nga Albulena Sylaj-Zeqiri, Prishtinë, 2016.

Zyra e Kryeministrit të Kosovës. "Programi i qeverisë 2015-2018". Mund të gjendet në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Government_Programme_2015-2018_eng_10_mars.pdf

UNESCO, Treguesit e sigurisë së gazetarëve: Niveli Kombëtar, Paris 2015, mund të gjendet në: http://www.unesco.org/new/fileadmin/MULTIMEDIA/HQ/CI/CI/images/Themes/Freedom_of_expression/safety_of_journalists/JSI_national_eng_20150820.pdf

UNESCO, Treguesit e Zhvillimit Mediatik: Një kornizë për vlerësimin e zhvillimit të mediave, Paris 2008, në dispozicion në: http://unesdoc.unesco.org/images/0016/001631/163102e.pdf

Dokumentet ligjore, politika

"Kushtetuta e Republikës së Kosovës". Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

"Kushtetuta e Republikës së Kosovës". Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, neni 42

"Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

"Ligji Nr. 02/L-65 Ligji civil kundër shpifjes dhe fyerjes" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, neni 8

"Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

"Ligji Nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave" Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, neni 5

"Ligji Nr. 04/L-046 për Radiotelevizionin e Kosovës". Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Kodi Nr. 04/L-082 i Procedurës Penale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 03/L-073 për zgjedhjet e përgjthshme në Republikën e Kosovës. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 03/L-172 për mbrojtjen e të dhënave personale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 03/L-178 për klasifikimin e informacioneve dhe verifikimin e sigurisë Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 03/L-212 i punës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, neni 88

Ligji Nr. 03/L-215 Law No. 03/L-215 për qasje në dokumente publike. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 04 / L-011 PËR organizimin sindikal ne Kosovë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Ligji Nr. 04/L-137 për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës

Artikujt të mediave

Greenslade, Roy. "Gazetari i TV në Kosovë goditet me thikë nga person i zemëruar nga raporti televiziv", (TV journalist in Kosovo stabbed by man angered by televised report) The Guardian, 29 tetor, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: https://www.theguardian.com/media/greenslade/2014/oct/29/journalist-safety-kosovo

Grup autorësh, "Zi për viktimat e sulmit të terrorit në Paris në Ballkan." Balkan Insight, 8 janar, 2015. Qasur më 21 tetor 2016 http://www.balkaninsight.com/en/article/at-least-12-dead-after-attack-on-french-satirical-newspaper-photos

Haxhijaj, Alberina "Gjobiten tri media", Kallxo, 9 korrik, 2016. Qasur më 28 korrik 2016 http://kallxo.com/gjobiten-tri-media/

Kallxo.com, "Rregullorja e Mospajtimeve", Kallxo.com. 30 maj 2016. Qasur më 5 maj, 2016: http: //kallxo.com/rregullorja-e-mospajtimeve/

Koha Ditore, "60 redaktorët dhe gazetarë të RTK-së reagojnë ndaj letrës së Shalës për Reporterët pa Kufij", Koha Ditore, 12 prill 2015. Qasur më 30 korrik 2016: http://koha.net/?id=&l=52614

Koha Ditore, "AGK Pengimi i gazetarit të "Kohës Ditore", mbyt lirinë e shprehjes". Koha Ditore, 12 prill, 2016. Qasur më 8 guasht 2016: http://koha.net/?id=27&l=107866

Koha Ditore, "Të gjithë kundër neneve 37 dhe 38." Koha Ditore, 23 qershor, 2016. Qasur më 10 tetor 2016: http://koha.net/?id=8&arkiva=1&l=104515

Koha Ditore, "Sindikata paralajmëron për nepotizëm në RTK." 14 gusht, 2014. Qasur më 14 tetor 2016: http://koha.net/?id=27&l=21548

Koha Ditore, "Asociacioni i Gazetarëve i bashkohet Federatës Evropiane të Gazetarëve." Koha Ditore, 8 qershor, 2016. Qasur më 10 tetor 2016: http://koha.net/?id=1&l=102745

Konjuhi, Filloretë. Sovran Syla u dënua me 4 vjet burg për sulmin ndaj gazetarit Milot Hasimja", Klan Kosova, 5 nëntor 2015. Qasur më 23 tetor 2016: http://klankosova.tv/sovran-syla-u-denua-me-4-vjet-burgim-per-sulmin-ndaj-gazetarit-milot-hasimja-video/

Kosova Press, "AGK kërkon fillimin e procedurave disiplinore kundër Dardan Nuhiut". 4 prill, 2016. Qasur më 5 gusht 2016: http://www.kosovapress.com/sq/lajme/agk-kerkon-pergjegjesi-nga-nuhiu-per-kercenimin-ndaj-gashit-39641/

Kosova Press, “Persona të armatosura sulmojnë selinë e portalit Kossev në veri të Kosovës”. Kosova Press, 11 qershor, 2015. Qasur më 2 gusht 2016: http://www.kosovapress.com/en/security/sulmohet-me-arme-selia-e-portalit-kossev-ne-veri-44410/

Koha Press, “Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës i bashkohet Federatës Ndërkombëtare të Gazetarëve.” Kosova Press, 8 qershor, 2015. Qasur më: 10 tetor, 2016 http://www.kosovapress.com/sq/lajme/agk-pranohet-ne-federaten-nderkombetare-te-gazetareve-75202/

Lajmi, “Shkarkohen dy anëtarë të KPM-së”, Lajmi.net. 26 dhjetor, 2013. Qasur më 11 tetor 2016: http://lajmi.net/shkarkohen-dy-anetare-te-kpmse/

Nushi, Paulina. “BIRN-i fiton çështjen ligjore kundër zyrës së kryeministrit të Kosovës”. Balkan Insight, 5 qershor 2013. Qasur më 4 gusht 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-wins-legal-case-against-kosovo-pm-s-office-10-29-2015

Osmani, Taulant. “Gazetarët dënojnë kërkesën e Turqisë për të ndëshkuar gazetarin kosovar për shkak të komenteve të grushtit të shtetit” Prishtina Insight, 7 korrik, 2016. Qasur më 4 gusht 2016: http://prishtinainsight.com/journalists-condemn-turkeys-request-punish-kosovo-journalist-coup-comments/

Peci, Edona. “Gjykata gjen të pafajshëm të pandehurit në rastin e BIRN në Kosovë”. Balkan Insight, 5 qershor 2013. Qasur më 2 gusht 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/defendants-in-birn-vs-infopress-case-acquitted

Popova, Erjone dhe Isufi, Perparim. “Transmetuesi kosovar përballet me kërcënimin e dëbimit”. Balkan Insight, 26 maj 2016, qasur më 2 gusht 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-public-broadcaster-under-privatization-agency-threats--05-24-2016

Popova, Erjone. “Gazetarët e Kosovës denoncojnë kërcënimet e pretenduara të kryeministrit”. Balkan Insight, 22 mars 2013. Qasur më 4 gusht 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-journalists-protest-against-prime-minister-s-threats-03-22-2016

Popova, Erjone. “Deputete kosovare kërkon dëmshpërblim për pretendimet e gazit lotsjellës”. Balkan Insight, 22 mars 2013. Qasur më 23 tetor 2016: http://www.balkaninsight.com/en/article/opposition-mp-sues-two-kosovo-media-for-1-5-m-03-24-2016

Qafmolla, Ervin. “Fitoret ligjore të BIRN vendosin precedent për transparencë”. Balkan Insight, 20 korrik 2013. Qasur më 4 gusht, http://www.balkaninsight.com/en/article/birn-legal-victories-set-precedent-for-transparency-07-19-2016

Rexhepi, Kaltrina. “Financat e RTK-së nga qeveria ulin kredibilitetin”. Kallxo.com, 1 korrik, 2015. Qasur më 22 tetor 2016 Mund të gjendet në: https://web.facebook.com/search/top/?q=sindikata%20sprtk%20profili%20zyrtar

Salihi, Njomza. “Kërcënohet gazetari Mefail Bajqinovci,” 2 korrik, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/gjnk/kercenohet-gazetari-mefail-bajqinovci-1/

Telegrafi “AGK dënon sulmet ndaj gazetarëve në Mitrovicë” 22 qershor 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://telegrafi.com/agk-denon-dhunen-ndaj-gazetareve-ne-mitrovice/

Telegrafi “Shoshi: AKI u përpoq të më rrëmbejë” Telegrafi.com, 4 dhjetor, 2013. Qasur më 10 tetor 2016: http://www.telegrafi.com/shoshi-aki-tentoi-te-me-kidnapoi/

Telegrafi. “AGK dënon kërcënimin ndaj kryeredaktorit të “Botës Sot”. 1 gusht, 2015. Qasur më 26 tetor 2016: http://telegrafi.com/agk-denon-kercenimin-ndaj-kryeredaktorit-te-botes-sot/

Zenelaj, Armend dhe Leposhtica, Labinot. “Selimi paraqet padi kundër Selisë së milionerëve”. Kallxo.com, 19 korrik, 2015. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/selimi-dorezon-padine-ndaj-shtabit-te-milionereve/

Zenelaj, Armend. “Drejtori i Arsimit në Deçan dënohet për kërcënimin e një gazetari”, Kallxo.com. 15 janar, 2014. Qasur më 23 tetor 2016: http://kallxo.com/gjnk/drejtori-i-arsimit-ne-decan-denohet-per-kercenim-ndaj-gazetarit-tv/

Zeri, “AGK reagon kundër qasjes së Federatës së Futbollit ndaj gazetës Zëri”. 5 nëntor, 2015. Qasur më 27 tetor 2016: http://217.172.190.248/sport/60282/agk-reagon-ndaj-qasjes-se-federates-se-futbollit-karshi-gazetes-zeri/